

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7863 E premte 26 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Është dilema më e re e kohëve të fundit për Kancelaren Merkel, CDU-në dhe koalicionin e madh qeveritar gjerman. Siç dihet, pas rezultateve zhgënjyese të CDU/CSU-së ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
Merkel, të qëndrojë apo të shkojë?


Opinion *i* **Ditës**
Më qëlloi dje rastësisht në një kafene të kap një bisedë plot ngjyrë të dy bashkëqytetasve të mi: "A e din", -i drejtohej më i moshuari tjetrit, me pasion ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Përrallat e 1 prillit dhe grabitja e 9 prillit




Agim Ismaili paralajmëron vartësit

Takime me të dënuar VIP, plas sherri mes krerëve të Burgjeve, zbardhen "e-mailët"

Bardhul Kaçori, drejtorit të Përgjithshëm: Dije se burgu nuk është magazinë kavanozësh

Nga KLODIANA LALA

TIRANË. Përplasje të forta mes krerëve të Burgjeve. "News24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë siguruar emailët zyrtarë të shkëmbyera mes Drejtorit të Përgjithshëm, Agim Ismaili dhe atij të Policisë, Bardhul Kaçori. Emailin e parë në adresë ...

Në faqen 9

MOSBINDJA CIVILE/ TYM DHE FLAKE, DIGJEN GOMA NE AKSET KYRESORE

"NUK DO KETE ZGJEDHJE", OPOZITA BLOKON RRUGET

Kreu i PD: Opozita nuk klonohet, as krijohet me mercenarë. Kryemadhi: Tërhiq, nuk e ke parë ende revoltën. 5 parti kërkesë Metës: Mblidh tryezën për zgjidhjen e krizës



(Në foto) Mbeshtetës të opozitës duke bllokuar hyrjen e Tiranës te rrethrotullimi "Shqiponja", gjatë një proteste

Në faqen 2-3

NDRYSHIMI I SISTEMIT
PS konsensus me opozitën e re, 90 vota për reformën zgjedhore
Në faqen 4

DEKLARATA
Rama: Zgjedhjet në 30 qershor, 7 vite burg për ata që i pengojnë ato
Në faqen 5

KATEGORITË E PAGAVE
Tabela me pagat e reja për Agjencinë Shtetërore të Kadasrës
Në faqen 6

DEBATI
Agron Tufa nxjerr dokumentet: Kundërshtari im ka prejardhje kufomash
Në faqen 19

AMBASADA AMERIKANE



Punësim sezonal për studentët në SHBA, kriteret për të aplikuar

Në faqen 13

Tabela/ 6 kategoritë që marrin asistencë, duhet të paraqiteni çdo 3 muaj

Pagesa e ndihmës ekonomike, kush e përfiton

Formula e pikëzimit, si bëhet verifikimi nga Shërbimi Social

NGA VOLTIZA DURO

Të gjithë ata persona apo familje që plotësojnë kriteret e paracaktuara mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot 6 kategoritë që iu lind e drejta të marrin pagesën si dhe kriteret e



dokumentacionin që duhet të plotësojnë të interesuarit. Përkatësisht në skemën e ndihmës ekonomike mund të përshihet familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; jetimët të cilët nuk janë në institucione; si dhe prindërit e fëmijëve ...

Në faqen 12

PROTESTA E OPOZITËS BLLOKIMI

Aleatët e Bashës takojnë Sorecën: Presidenti të iniciojë dialogun pozitë-opozitë

Zgjidhja e krizës "në dorë" të Metës, krijohet qendra e djathtë

Partitë aleate të PD-së kërkojnë lista të hapura

Valentina Madani

Partitë aleate historike të Partisë Demokratike krijuan dje Grupimin e Qendrës së Djathtë, i cili synon arritjen dhe imponimin e standardeve demokratike në zgjedhje. Kërret e të 5 partive Fatmir Mediu i PR, Agron Duka i PAA, Nard Ndoka i PDK, Dashamir Shehi i LZHK dhe Vangjel Dule i PBDNJ kanë rënë dakord për të zhvilluar veprimtarinë e tyre si një forum i përbashkët dhe në përpunje të plotë me platformën politike të pranuar dhe nënshkruar si marrëveshje e tyre me Partinë Demokratike. Pesë parti, pjesë e koalicionit të PD-së, prezantuan strategjinë e tyre, duke theksuar se qëllimi është rritja e presionit për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Në takimin e mbajtur dje këto parti unifikuan qëndrimin e tyre për sa i përket sistemit zgjedhor dhe kërkojnë ndryshimin e tij, duke propozuar modelin e listave të hapura. Por, padyshim që një nga pikat kryesore është zhvillimi i zgjedhjeve me standarde demokratike pa Edi Ramën kryeministër. Takimi i djeshëm ishte vetëm i pari i një seri takimesh që janë planifikuar të zhvillohen në të gjithë qarqet e vendit, ku do të trajtohen të gjitha temat që janë prioritet i aksionit opozitar.

KËRKESAT

Aleatët e Lulzim Bashës kërkojnë ndryshim të Kodit Zgjedhor dhe lista të hapura në zgjedhjet e përgjithshme. Këto propozime u materializuan në një forum që 5 partitë organizuan në kryeqytet, si pjesë e vijimit të platformës së firmosur me Partinë Demokratike. Kështu, PR, PAA, PDK, LZHK, PBDNJ thanë se kandidatët për deputetë nuk duhet të zgjidhen më nga lideri politik. Kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi, u shpreh: "Kush ka hipur në



Tryeza e djeshme e aleatëve të PD-së

TRYEZA

"Në këtë moment, ne si forca politike mendojmë se është përgjegjësia jonë të negociojmë me të gjitha palët dhe institucionet për këtë dialog. Ne do t'i kërkojmë Presidentit të Republikës të thërrasë një tryezë të pozitës dhe opozitës për të zgjidhur këtë situatë, për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme", tha kreu i PR-së.

BD regjistrohet në gjykatë, me një deputet në Kuvend

"Bindja Demokratike", Rama: Të futi Saliu. Patozi: Ti i bie të jesh i Enverit


Partia "Bindja Demokratike" u regjistrua dje në Gjykatën e Tiranës. Ajo paraqiti dy ditë më parë kërkesën për regjistrim me katër mijë firma. Kjo parti do të ketë një deputet në Kuvend. Ai është Andi Përmeti, i cili një javë më parë mori mandatin e deputetit nga KQZ-ja, si kandidat në listat e PD-së, në zgjedhjet parlamentare të 2017-ës në qarkun e Korçës, pasi opozita dogji në bllok mandatin. Por, kryeministri Edi Rama mendon se "Bindjen Demokratike" e ka krijuar Sali Berisha. "Na doli që unë paskam formuar 'Bindjen Demokratike'. Pse e kam formuar unë 'Bindjen Demokratike' dhe nuk e firmoi Saliu?! Pse?! Pse e formova unë 'Bindjen Demokratike' me Astrit Patozin dhe nuk e firmoi Saliu? Ku ndryshon Astrit Patozi nga Saliu?! Në



një pikë të vetme, ose më saktë nga Luli. Luli bashkë me Saliun merrnin pjesë në afëra të mëdha të qeverisë dhe Astriti vinte këtu dhe i bënte avokatim me duar në xhëpa, pa qenë asnjëherë në pushtet. Astrit Patozin e ka futur Saliu në zgjedhje jo unë, një çun për rrugë dhe një çun për zgjedhje dhe pastaj shohim ku të dalë", theksoi z.Rama. Por, koordinatori i "Bindjes Demokratike", Astrit Patozi

shpreh se Rama është "pickuar" nga "Bindja Demokratike" njësoj si shumë të tjerë, që po rremojnë në biografinë e saj vetëm dytore, duke e sulmuar atë që në bark të nënës. Por, ky reagim nuk e habit Patozin, pasi sipas tij Rama më shumë se kushdo tjetër në Shqipëri është i trembur nga çdo lëkundje, që mund të trazojë mocalin e pistë të kryetarokracisë. Teksa Rama iu referua si i biri i Saliut, Patozi i kujton se babai i tij është Hiqmet Patozi dhe nëse marrim të njëjtin kontekst, i bie që kryeministri është i biri i Enverit, shpreh Patozi. "Madje mund të them me bindje (edhe demokratike, po të duash) se po të lamë të qëndrosh për shumë kohë në atë karriqe, ke mundësi edhe që t'ia kalosh. Por ti mos u gëzo kot, se kjo nuk ka për të ndodhur", - theksoi z.Patozi.

di se: "Ne kemi një bashkëpunim politik prej vitesh për kauzën tonë të përbashkët". Ky lloj formati i nisur në Tiranë do të vijojë në të



Protesta e djeshme e opozitës te rrethrotullimi i Shqiponjës

"Fati i tyre, prapa hekurave", Vasili: Rilindja, produkt i shitblerjes së votës

Ish-kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, Lakuzoi dje se rilindja është produkti i shitblerjes së votës. Vasili tha se të gjithë ata që janë përfshirë në dosjen '339', apo në abuzime të tjera do të shkojnë në burg. "Ky është një parlament dhe rilindja që e ka zaptuar është produkti më i shëmurtë i shitblerjes së votës në vend. Këtë e thotë raporti i OSBE-ODIHR-it, i cili nënvizon qartë se vetëm LSI dhe PD denonuan shitblerjen e votës. Të njëjtën gjë pohon raporti DASH, i cili u vë damkën zgjedhjeve që u karakterizuan nga shitblerja e votës. Burgu pret vetëm ata, goftë dosja '339', goftë audiopërgjimet, goftë 'Unaza e Madhe', goftë Bregu i Lumit, goftë koncesionet janë dëshmi të pakundërshueshme që i kanë përcaktuar një fat kësaj qeverisjeje, fundi i tyre është vetëm një, prapa hekurave", u shpreh z.Vasili.

gjitha qarqet e vendit si pjesë e aksionit opozitar.

TAKIMI

Partitë e djathta, aleatët të Lulzim Bashës, me kërkesë të tyre takuan dje kreun e delegacionit të Bashkimit Evropian në vendin tonë, Luigj Soreca. Në takim ishin Mediu, Shehi, Dule, Duka, Ndoka, të cilët pas takimit me z.Soreca thanë se kanë vendosur t'i kërkojnë Presidentit Ilir Meta të ndërhyjë për zgjidhjen e kësaj krize, duke ulur në një tryezë mazhorancën dhe opozitën. "Ne do t'i kërkojmë Presidentit të Republikës të thërrasë një tryezë të pozitës dhe opozitës për të zgjidhur këtë situatë, për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme. Opozita nuk ka asnjë qëllim tjetër, përveçse garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe qytetarët të vendosin se kush duhet ta aktivizojmë çdo qelizë të shqërisë, të sensibilizojmë edhe partnerët ndërkombëtarë për fatin e demokracisë, me qëllim që zgjidhja të vijë sa më shpejt dhe me sa më pak kosto. Përvojat e hidhura të së shkuarës duhet të na bëjnë më të matur dhe sidomos mazhorancën dhe kryeministrin, të cilët nuk janë ndërgjegjësuar akoma dhe sillen me arrogancë".



Protestë nën tym e flakë, digjen goma në akset rrugore, konfrontime të "Shqiponja"

Mosbindja civile, opozita bllokoi rrugët, Basha: Zgjedhje s'do të ketë

"Opozita nuk klonohet, as krijohet nga mercenarët e Ramës"

Valentina Madani

Opozita bllokoi dje nga ora 18:00 deri në orën 19:00 qarkullimin rrugor pothuajse në gjithë vendin. Pasditën e djeshme protestuesit e opozitës bllokuan 5 akse rrugore kryesore, duke i mbajtur të bllokuara në shenjë proteste. Bllokimi zgjati më shumë se 60 minuta ndërkohë që kreu i opozitës Lulzim Basha udhëhoqi protestën në Milot kurse kryetarja e LS-së në Durrës. Gjatë protestës të rrethrotullit i "Shqiponjës", në Tiranë pati një konfrontim mes protestuesve dhe një qytetari, i cili tentoi të çajë me makinë turmën, por nuk është lejuar. Në protestën e opozitës, krahas bllokimit të rrugëve, nuk munguan edhe flakadanët dhe djegia e gomave sidomos të rrethrotullimit i Milotit dhe sheshi "Shqiponja" në Tiranë. E njëjta situata ishte edhe në Bradashesh të Elbasanit dhe në rrethrotullimin e Plepave në Durrës dhe në Fier. Protestuesit kërkuan largimin e kryeministrit Rama me thirrjet "Rama ik" ndërsa i vunë flakën gomave të makinave dhe ndezën flakadanë. Edhe dje opozita akuzoi për të infiltuar në mesin e saj. Sekretari organizativ i PD-së, Sahit Dolapi bashkë me një grup protestuesish, larguan nga protesta disa individë që sipas tyre ishin agjentë civilë. Dolapi kontaktoi edhe me dretuesit e policisë duke i kërkuar të shmang provokimet. Pas kësaj demokratët larguan 4 persona të identifikuar si policë civilë në radhët e protestuesve.

DEKLARATA
Lideri demokrat Lulzim Basha mes protestuesve në Milot bëri të qartë se opozita shqiptare nuk do të lejojë që me 30 qershor të zhvillohen zgjedhje, pasi sipas tij, me Edi Ramën kryeministër nuk mund të ketë garë të ndershme. Ai theksoi se në vend nuk ka opozitë tjetër, por opozita e vërtetë është PD-ja me aleatët e saj. "Pa zgjedhje të lira nuk mund të ketë dalje nga varfëria. Vendimet e padrejta, vendimet kriminale si ai i taksës Rama që ka bërë karburantin e shqiptarëve më të shtrenjtin në Europë, ndërkohë sot shqiptarët janë popullit më i varfër në Europë. Themeli i kësaj të keqe është rënia e demokracisë, është rënia e votës. Pa vota të lira nuk i jep qeveria llogari popullit, por krimin. Pa zgjedhje

të lira nuk hapen dyert e Europës. PD dhe opozita e bashkuar është sot koalicioni më i madh numerik, moral. Edi Rama e lidhi fatin me hajdutët. Edi Rama është shërbëtor i ortakëve të tij në krim. Këtë betejë do ta fitojmë për demokracinë. Në 30 qershor nuk ka për të patur zgjedhje në Shqipëri. Dhe këtë e di bufi dhe vëllai i bufit Edi Rama. Nuk ka zgjedhje. Opozita nuk

klonohet dhe as nuk krijohet nga mercenarët që i shërbejnë pushtetit. Ka vetëm një opozitë, ajo jemi ne. Nuk ka zgjedhje me 30 qershor, sepse ne jemi të vendosur të mos lejojmë krimin elektoral", deklaroi z.Basha. Ai garantoj se opozita do të shkojë deri në fund betejës për zgjedhje fund. Do të ketë zgjedhje të lira. "Zgjedhje farse nuk do të ketë më. Në burg do të shkojë Dako,

Gjijnuri dhe të gjithë bashkëpunëtorët politikë të Edi Ramës, të cilët janë kapur duke trafikuar zgjedhjet e shqiptarëve. Mos të lejojmë më krimin elektoral, por të luftojmë sy për sy dhe dhembë për dhembë për liri dhe demokraci. Vetëm kështu mund të kthejmë stabilitetin. Zgjedhjet e lira të ndershme janë të mundur kur kujdestari nuk do të jetë më kryeministri. Zgjedhjet me Edi Ramën nuk janë zgjedhje nuk janë zgjedhje, por krim. Largimi i tij është kusht i panegociueshëm i PD, opozitës dhe i të gjithë popullit të bashkuar për demokraci. Le ta dinë shumë mirë, sepse kjo e sotmja është fillimi i mosbindjes civile". - theksoi z.Basha. Ai shtoi se krijimi i një qeverie tranzitore mund të shmangë ndonjë përballje të mundshme mes popullit dhe gjakatarëve që janë sot në pushtet. "Krijimi i një qeverie tranzitore mund të shmangë edhe përballjen mes popullit shqiptar e kësaj kliske kriminale e gjakatare. Opozita dëshiron një Shqipëri europiane, që marshon drejt punës dhe mirëqenies. Ramës dhe bandës së tij po i mbaron koha, se 30 qershori do të jetë dita e triumfit të shqiptarëve të lirë. Nuk lejojmë krimin elektoral në atë ditë, për asnjë moment", theksoi z.Basha.



Kreu i opozitës Lulzim Basha, dje në Milot

EDI PALOKA
"Në rast se do vijohet me cinizëm në afrimin e zgjedhjeve, jo vetëm ai që nuk e ndal dot situatën, por sikur të mbledhë gjithë socialistët e Europës nuk na ndal dot. Ne jemi në luftë për mbijetesë, shqiptarët janë në pikën për mbijetesë", - tha nënkryetari i PD-së Edi Paloka.

Kryemadhi thirrje-Ramës: Tërhiq, akoma nuk ka filluar mosbindja civile

Nga kryqëzimi i Durresit, një ndër 5 pikat e bllokuar në të gjithë vendin, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi se këto protesta janë paralajmërim për kryeministrin Rama, pasi mosbindja civile nuk ka nisur ende. Më tej Kryemadhi i kërkoi Ramës të dorëhiqte sepse vetëm po shkatërron shqiptarët. "Pjesa më e madhe e protestave ka qenë me qytetarët e Tiranës, tashmë do të shpërndahemi në të gjithë Shqipërinë. Befasia ndaj strategjisë që Edi Rama ka ndërtuar me krimin e organizuar për të uzurpuar shqiptarët, do të jetë elementi kryesor i protestës së shqiptarëve. Këto nuk janë më protestat e opozitës janë protestat e qytetarëve. Është paralaj-



SIMBOLIKA
Të rinjtë e FRPD dhe LRI protestuan dje në një formë ndryshe para Kuvendit. Të rinjtë simbolikisht vendosën përpara parlamentit 200 këpuçe me flamujt e vendeve të BE, ku kanë emigruar të rinjtë shqiptare, duke ikur nga varfëria dhe pasiguria e krijuar në vend. Të rinjtë mbajtën në duar parullën "Ti Shqipëri s'më jep nder, me jep emrin mërgimtar".

jmërim për Ramën. Akoma nuk ka filluar mosbindja civile. Akoma Edi Rama nuk e ka parë revoltën e shqiptarëve. Ka vetëm 9 javë për të kuptuar ndërkombehtarët. Edi Rama nuk e ka kuptuar ende. Sot protestat në pesë pikat kryesore janë protesta për t'i thënë Edi Ramës se je akoma vonë. Tërhiq dhe jepu shansin shqiptarëve të bëjnë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Të gjithë shqiptarët që janë në Amerikë t'u telefonojë të afërmit të tyre në Shqipëri që të bëhen pjesë e protestave kundër qeverisë së krimin", -deklaroi Kryemadhi.

DENONCIMI
PD do të denoncojë së shpejti një tjetër aferë korruptive të qeverisë që ka të bëjë me shitblerjen e votës që sipas saj janë përfshirë në aktivitet kriminal anëtarët e qeverisë. "Konfirmoj që po, kemi informacione, të cilat i kemi në përpunim dhe verifikim të mëtejshëm, dhe sapo të jenë të gatshme për tu ndarë me opinionin publik sigurisht që do të bëjmë denoncimin përkatës", - tha z.Bardhi.



PD, Bardhi: Sot bllokojmë rrugët, nesër zgjedhjet false

PD-ja përmes sekretarit të përgjithshëm Gazmend Bardhi akuzoi dje Kryeministrin Edi Rama për bllokim të rrugës së Shqipërisë drejt BE-së. Për demokratët, shqiptarët e kanë kuptuar skemën grabitëse të kësaj qeverie ndaj sot me ndalimin e makinave në gjithë Shqipërinë dhe nesër me ndalimin e zgjedhjeve false. Sekretari i përgjithshëm i PD u shpreh se nuk do të lejojë që të ketë zgjedhje në 30 qershor, siç deklaroi më herët në parlament kreu i grupit parlamentar i PS, Taulant Balla dhe kreu i qeverisë, Edi Rama. Sipas Bardhit nuk mund të ketë zgjedhje të lira me një kryeministër të kapur nga krimi dhe korrupsioni, ndërsa shtoi se sot do të bllokohen rrugët, e ndërsa nesër do të bllokohen zgjedhjet. "Zgjedhjen nuk ka për të pasur. Një qeveri, kryeministër ilegjitim, që e shndërroi Shqipërinë në një narkoshtet nuk mund të organizojë zgjedhje të lira. Alternativa e tij është gazi, taksat, papunësia, nuk ka asnjë ide, asnjë program. Edhe kur nis të bëjë gjoja një punë, nuk e drejton vizioni dhe ligji, por antiligji dhe korrupsioni. Ka vjedhur taksat. Nuk punon në interes të qytetarëve. Sot ndalimi i makinave, nesër me ndalimin e zgjedhjeve. Kruga jona pa kthim. E vetmja rrugë drejt BE, janë zgjedhjet e lira", - u shpreh z.Bardhi.

3H SHQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fah Dada", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kk. 1, Tiranë
Web: www.3h.al; Email: shqgj_3h@yahoo.com cel:0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.23.04.2019 deri ne dt. 02.05.2019 pers.sendin e luajtsheem- gjysem rirmorkjo, marka Shmitz, Spr me Targa AER 936, me cmim fillestar 199,824.00 Leke automjetin gjysem rirmorkjo marka general trailers, F34 me Targa AER 360 me cmim fillestar 169,850.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L
Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 02.05.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

KUVENDI REFORMA

Komisioni i ri do të bashkëdrejtohet nga Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari

PS konsensus me opozitën e re, 90 vota për reformën zgjedhore

Ndryshimi i sistemit zgjedhor bëhet pjesë e reformës

Mazhoranca dhe opozita e re në parlament kanë gjetur konsensusin e parë. Kuvendi votoi dje me votat e deputetëve të të dyja krahëve ndryshimet në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Vendimi është miratuar me 90 vota pro dhe 1 abstenim të një prej deputetëve të rinj, duke rinovuar kështu jo vetëm përbërjen e tij, por edhe duke ndryshuar objektin e punës së tij. Kështu sipas këtij vendimi komisioni do të përbëhet tashmë nga 12 anëtarë, dhe do të drejtohet nga dy bashkëkryetar, Damian Gjijnuri si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Rudina Hajdari si përfaqësuese e Grupit Parlamentar Demokrat. Ndërkohë që anëtarët të këtij komisioni do të jenë Bashkim Fino, Alket Hyseni, Klotilda Ferhati, Blerina Gjylameti dhe Vasilika Hysi nga Partia Socialiste dhe Myslim Murrizi, Andi Përmeti, Korab Lita, Nimet Musai anëtar dhe Ralf Gjoni si përfaqësues të opozitës. Nga ana tjetër me vendimin e djeshëm Kuvendi ka ndryshuar edhe objektin punës së këtij komisioni. Kështu veç çështjeve që ishin dhe më parë në objektin e punës, është përfshirë edhe hapja e diskutimit për ndryshimin e sistemit zgjedhor. Gjithsesi përfshirja e kësaj pike nuk do të thotë automatikisht që në fund të punës së këtij komisioni do kemi ndryshim të sistemit zgjedhor. Kjo pasi socialistët kanë pranuar vetëm të zhvillojnë një diskutim të kësaj çështjeje, por jo të ndryshojnë sistemin. Drejtuesit më të lartë të PS-së kanë bërë të qartë se janë kundër ndryshimit të sistemit, duke theksuar se sistemi aktual është më i miri në kushtet e Shqipërisë. Nga ana tjetër opozita kërkon një sistem proporcional kombëtar me lista të hapura. Sipas tyre vetëm kështu e drejta e zgjedhjes së deputetëve do i jepet qytetarëve dhe jo kryetarëve të partive politike. Lidhur me këtë vendimmarrje kryetarja e Grupit Parlamentar Demokrat, Rudina Hajdari e cilësoi miratimin e këtij vendimi një sukses të opozitës. Kjo pasi sipas saj opozita e re parlamentare arriti të imponojë hapjen e diskutimit për ndryshimin e sistemit zgjedhor. "Në komisionin e ri do kemi disa amendime. Amendimi i ri ka të bëjë me futjen e ndryshimit të sistemit. Kjo është një arritje shumë e madhe për opozitën dhe gjithë vendin. Ne do bëjmë të pamundur që të arrijmë të gjitha objektivat që kemi parashtruar me maxhorancën. Përtë rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, ne do bëjmë të mundur që të eliminonim shit-blejen e votave dhe do eliminonim përdorimin e administratës zgjedhore", - tha Hajdari. Ndërkohë që Taulant Balla u shpreh se PS do të ketë një kusht të vetëm



Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, gjatë seancës së djeshme parlamentare

BALLA: SPAHO MË ANKOHEJ ÇDO NATË PËR LSI
Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ka treguar edhe se si vetë demokratët në zgjedhjet e 2017 ankoreshin për blerjen e votave nga LSI. Për këtë ai bëri të ditur se në zgjedhjet e shkuara parlamentare, Edmond Spaho që ishte drejtues politikë i PD-së për Qarkun Elbasan i ankohej atij për blerjen e votave të demokratëve nga ana e LSI-së. "Çdo natë të fushatës së 2017 kisha një bisedë me kryetarin e grupit të PD-së, Edmond Spaho në telefon që më tregonte si histori pa fund të LSI-së që vidhnin dhe blinin vota në Elbasan", - tha Balla.



Seanca e djeshme parlamentare

PËRBËRJA E KOMISIONIT

| GRUPI IPS | OPOZITA E RE |
|-------------------------------|-------------------------------|
| Damian Gjijnuri bashkëkryetar | Rudina Hajdari, bashkëkryetar |
| Bashkim Fino anëtar | Myslim Murrizi anëtar |
| Alket Hyseni anëtar | Andi Përmeti anëtar |
| Klotilda Ferhati anëtar | Korab Lita, anëtar |
| Blerina Gjylameti anëtar | Nimet Musai anëtar |
| Vasilika Hysi, anëtare | Ralf Gjoni anëtar |

Shpenzimet në fushatë zgjedhore të 2017 ishin 23 mln euro

Partitë politike nuk tre gojnë të vërtetën kur raportojnë lidhur me shpenzimet financiare gjatë fushatave elektorale. Kështu, ekspertët deklarojnë se shpenzimet në fushatë janë disa herë më të mëdha se ato që deklarohen në KQZ. Besart Kadia shprehet se nga përlogaritjet rezultojnë se kostoja për fushatën e shkuar ishte 23 mln euro nga 1.8 që janë deklaruar zyrtarisht. "Ne na rezultojnë kostot e fushatës të deklaruara janë 1.8 milionë euro zyrtarisht nga të gjitha partitë politike në Shqipëri për zgjedhjet e fundit në 2017, ndërkohë që të paktën me pyetësin që të kemi pasur me deputetë apo kandidatë për deputetë vjetër të që shifra është më e



lartë. Përafërsisht, njëzë që janë marrë me këtë në mënyrë anonime janë shprehur se kosto shkon deri në 23 milionë euro në fushatën elektorale të 2017", - tha Kadia.

Ndërkohë që ambasadori britanik, Norman Duncan, bëri apel për më shumë transparencë në lidhje me financimin e partive. "Transparenca e financimit të partive është e rëndësishme. Partitë dhe kandidatët mund të blejnë zgjedhje duke luajtur pishë dhe kjo prek demokracinë e një vendi. Pikërisht për këtë transparenca është e rëndësishme pasi rrit besimin të publikut", - tha ambasadori. Ndërsa sekretari socialist për çështjet zgjedhore, Damian Gjijnuri premtoi se financimet do jenë pjesë e rëndësishme e reformës zgjedhore, ndërsa propozoi ndryshime ligjore që mund të shkojnë deri në heqje mandatesh në rast të deklarimeve të rreme.

në punën e këtij komisioni, atë të përfshirjes në diskutim të votës së emigrantëve. "Ne nuk kishim asnjë kusht për Reformën Zgjedhore edhe me paraardhësit tuaj. Këtu, në këtë sallë, paraardhësve tuaj u kam thënë: merrni një letër të bardhë, shkruajeni si ta doni Reformën Zgjedhore dhe ne do ta miratojmë. Për ne do të rëndësishme është të kemi zgjedhje demokratike, të kemi zgjedhje sipas të gjitha standardeve. Unë jam shumë i sigurt që zgjedhjet e 30 qershorit do të jenë zgjedhje të mira e demokratike. Përhëndës të

gjithë ato 42 parti të regjistruara për të marrë pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit. Rekomandimet e OSBE/ODIHR janë pjesa themelore e punës së komisionit. Kemi rënë dakord, pas konsultimeve me dy

kryetarët e grupeve të opozitës, që ne të fillojmë punën për ashpërsimet lidhur me "gjëmen", me pjesën më negative të proceseve zgjedhore, atë të shitblerjes së votës", - tha Balla.

Ruçi kundër RTSH-së: Boll me raporte të gënjeshtra

Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi është shprehur me tone kritike për punën e Televizionit Publik Shqiptar dhe për pasqyrimin e jetës parlamentare, si dhe në plotësimin e kushteve që çdo qytetar taksapagues të ketë akses në informacion dhe çdo lloj programacioni tjetër. Nisur nga diskutimi mbi raportin vjetor të Këshillit Drejtues të RTSH-së, Ruçi ka theksuar se ky TVSH nuk pasqyron as aktivitetet e vet Kuvendit, pavarësisht se paguhet nga taksat e qytetarëve shqiptar. "Ne jemi këtu përfaqësues të atyre që na kanë zgjedhur dhe po na pyesin çfarë po raportoni kur televizioni publik shqiptar ka të tërë kanale dhe unë nuk i ndjek dot ato, dhe ju flisni për paradat e sukseseve tuaja. Unë flas për ata që nuk kanë televizorin tënd dhe timin. Është i vetmi kanal që taksapaguesit shqiptar janë aksionerë në financat e TVSH-së dhe e paguanë ata, 12 mijë lekëshin. E dyta, vërtitet një kanal tjetër, RTSH Kuvendi, diskutojnë deputetët dhe nuk merakosen për veten kur do të transmetohet në mënyrë permanente. E treta, një pjesë e zgjedhësve janë me aftësi të kufizuara dhe kërkojnë nga ne kur TVSH do na mundësojë të ndjekim Kuvendin përmes gjuhës së shenjave", - tha Ruçi. Ndaj ai ka kërkuar që problematikën e ngritura të reflektohen dhe raportet të mos bëhen sa për të kaluar radhën. "Prandaj raportimet dhe rezultatet nuk duhet të jenë formale, por efektive, brenda shqetësimeve që kanë njerëzit që na kanë zgjedhur", -tha Ruçi.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e parë për pasurinë:

1- "ARE", me sipërfaqe totale 3,820.00 m², e ndodhur në Rrethi KAVAJE, Q/IF BAGO ,Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Zona Kadastrale: 10/72, Numri i Pasurisë: 124/9, Vol. 3, Faza 17, në pronësi të Rifat Brahman Estradi (Rifat Brahman Istrefi). Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 1.005.424 (një milion e pesë mijë e katërqind e njëzet e katër) LEKË.
Ankandi i parë për pasurinë e mësipërme zhvillohet me datë 08.05.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyris së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslim Shyri, villa nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 06959381883.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Zyra Përbarimore Fier me përbarues gjyqësor Arian CEPELE me adresë Lagja "29 Nentori" godina e Gjykatës Fier nga mbrapa, njofton se më datë 18.04.2019-02.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i 1-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr. 7/32, ZK 2890, me sipërfaqe 1124 m² me adresë Patos, Fier, në pronësi Z.Haxhi & Gjyle Rrapaj me vlerë fillestare në ankand 4 960 000 (katërmilionentëqindgjatëdhjetëmijë) LEK.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 697262655.



GAZI LOTSJELLËS

"Gazi lotsjellës, protokoll uniformë i gjithë vendeve. Aty ku nuk funksionon, kërcet dajaku, kurse këtu jo. Këtu dajakun e ha policia që rri përballë merr gurët, merr kapsollat e çfarë t'ju dalë para dhe plus duhet të ruhet edhe nga lart se mos bie ndonjë nga pema", - tha kryeministri.



PS i jep opozitës së re postin e nënkryetarit të Kuvendit

Shumica parlamentare është e vendosur që t'i krijojë të gjitha kushtet opozitës së re për tu ndjerë e barabartë në jetën parlamentare. Pas përfshirjes në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, mazhoranca e majtë i ka ofruar opozitës së re parlamentare edhe disa pozicione drejtuese në Kuvendin e Shqipërisë. Kështu, kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, bëri të ditur dje se deputetët e opozitës kanë të drejtën e tyre që të propozojnë dhe zgjedhin një nënkryetar Kuvendi, duke plotësuar kështu vendin e lënë bosh nga Edi Paloka. Përveç tij, Balla theksoi se deputetët e opozitës kanë të drejtën të propozojnë edhe disa deputetë të tjerë si kryetarë dhe nënkryetarë komisionesh të përhershme parlamentare. "Ju jeni deputetë tërësisht legjitimë në funksionin tuaj. U bëj thirrje të dyja grupeve të konturuara tashmë, ju lutem bëni propozimet për të marrë të gjitha pozicionet që i takojnë opozitës. Tre kryetarët e komisioneve, nënkryetarin e parlamentit dhe të gjitha delegacionet e tjera, të cilat me të drejtë i takojnë opozitës. Punë të mbarë në këtë ushtrim demokratik të punës së parlamentit", - tha Balla. Ndërkohë që gjatë seancës së djeshme parlamentare kanë bërë betimin edhe 6 deputetë të tjerë të rinj të opozitës, që kanë marrë mandatin nga KQZ-ja gjatë këtyre dy javëve të fundi, duke e çuar kështu në 109 numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit dhe në 30 numrin e përfaqësuesve të opozitës.

Nga foltorja e Kuvendit, Kryetarja e grupit parlamentar demokrat, Rudina Hajdari, e konsideroi arritje për opozitën parlamentare futjen në axhendën e Komisionit të Reformës Zgjedhore diskutimin për ndryshimin e sistemit zgjedhor. Ajo theksoi se e keqja e gjithë asaj që ka ndodhur në Shqipëri gjatë këtyre viteve janë pikërisht ndryshimet kushtetuese, që bëjnë të mundur edhe ndryshimin e sistemit zgjedhor në proporcional rajonal me lista të mbyllura. Më tej, gjatë fjalës së saj, ajo iu drejtua të gjitha palëve që të ulen në bisedime për t'i dhënë fund krizës politike. "Do të kërkoja me përlulje të pranoni ftesën time që t'i jepni fund kësaj krize, asnjë nuk do që ne të kemi përbalje civile. Kemi kaluar shumë në këtë vend, kemi pasur situata të vështira

Kryeministri: Mos e merrni shumë seriozisht Bashën

Rudina Hajdari: Ju kërkoj me përlulje t'i jepni fund krizës

dhe ne me vullnet të plotë mundemi dhe duhet ta evitojmë këtë situatë", - tha Hajdari. Më tej, ajo i ka kërkuar kryeministrit që të lërë menjëherë batutat dhe etiketimet për kundërshtarët politikë dhe të merrtet me gjëra konkrete dhe ballafaqim idesh. "Pse merreni me Bashën, Kryemadhin e Berishën? E morëm vesh. Ata kanë pasur ekspansionin e tyre, problemet e tyre, abuzimet e tyre, janë provuar dhe shqiptarët nuk i kanë besuar, kështu treguan edhe zgjedhjet e fundit", - u shpreh më tej Hajdari. Duke replikuar me të, kryeministri Edi Rama



tha se falë marrëveshjes për ndryshimet kushtetuese, sot ajo vetë personalisht, dur edhe shumë zonja të tjera janë në parlament. "Humori është

e vetmja armë për t'iu kthyer brutalitetit pa rënë në brutalitet dhe nga ana tjetër nuk mendoj se nërëzimit i ka ardhur ndonjë e keqe nga e qeshura. Tani po të mos ishte marrëveshja e 2009-ës, ju nuk do të ishit në parlament, ja një e mirë që ka sjellë. Shqipëria ka prej vitesh zgjedhje ku fitimtari del fitimtar dhe humbësi nuk del dot fitues me asnjë metodë. Ju jap një këshill, mos e merrni seriozisht shumë as Bashën dhe as partinë që latë dhe qeshni pak se do të ndiheni më mirë dhe do të shikoni më larg", - tha Rama.

Kryeministri deklaroi se PS-ja ka bërë gjithçka që opozita të futej në zgjedhje

Rama: Zgjedhjet në 30 qershor, 7 vite burg për ata që i pengojnë ato

"Nuk kemi pasur problem PD-në, por simotrën tonë, LSI-në"

Zgjedhjet për pushtetin vendor do të mbahen në 30 qershor dhe kushdo që do tentoi t'i prishë ato, do të përballet me ligjin. Mazhoranca e majtë është e vendosur që të mos bëjë asnjë hap pas sa i përket vendimit të saj për të shkuar në zgjedhjet vendore në datën e dekretuar nga Presidenti i Republikës, pavarësisht faktit se opozita ka vendosur të mos marrë pjesë në to, pa pasur më parë garancitë për një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm. Kryeministri Edi Rama duke folur dje nga foltorja e Kuvendit, ka ripërsëritur me forcë se mazhorancën dhe Shqipërinë nuk do mund ta ndalin dot kërcënimet e opozitës, duke deklaruar prër se shqiptarët do të votojnë në 30 qershor për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiak, ndërka ka paralajmëruar se kushdo që tentojtë t'i blloktoj apo t'i prishë ato, do të përballet me burgun. "Është shumë e rëndë dhe e padëgjuar, e parranueshme nga askush, as nga vet shumica dërrmuese e zgjedhësve të Bashës apo Kryemadhit. Por, ndërkohë



Kryeministri Edi Rama

edhe ne nuk kemi ndonjë zgjedhje tjetër përveç se të vijojmë rrugën tonë pa u ndaluar të merremi me ta, domethënë pa devijuar nga rruga e zgjedhjeve të 30 qershorit, pavarësisht kërcënimeve, shantazheve apo rreziqeve", - deklaroi Rama. Gjithsesi, ai pranoi se zgjedhjet pa opozitën nuk janë normale, por theksoi se kjo është e vetmja zgjidhje në kushtet kur partitë opozitare kanë vendosur të mos marrin pjesë në to. "Unë i mirëkuptoj të gjithë ata që ndryshe nga unë, ndryshe nga ne, mendojnë se këto zgjedhje janë anormale, por dua t'ju them se kjo nuk është as zgjedhja jonë e as faj

ynë. Në këndvështrimin tim, kemi bërë gjithçka që kjo të mos ndodhë. Mund të bënim shumë mbase, unë nuk e kam", - u shpreh Rama. Madje, ai shtoi se edhe aktualisht mazhoranca i ka ofruar PD-së, pavarësisht se nuk është në parlament, statusin e veçantë për të qenë bashkëkryesuese e reformës zgjedhore. "Jemi prapë në të themi hajt tua lëmë një vend këtyre. Dëgjoni dhe Murrizin që na bën histori këtu, na tregon lidhjet intime me Oerd Bylykbashin", - shtoi ai. Duke iu përgjigjur edhe deklaratave të opozitës se nuk do lejohen të zhvillohen zgjedhjet, Rama u ka kujtuar atyre

parashikimet ligjore. "Pëngimi i zgjedhjeve për të votuar personi dënohet 1-5 vite dhe 3-7 vite kur bëhet në bashkëpunim. Nëse ka budallenj që janë gati të përballen me këtë ligj të votuar nga parlamenti me iniciativë të PD-së dhe PS-së kur ishte në opozitë, për hatër të Lulit apo pse filxhani s'e ka nxjerrë akoma qartë, le të shkojë. Por, unë besoj se nërëziti do të fillon dhe do të kuptojnë", - tha Rama. Kreu i qeverisë u mor gjatë në fjalën e tij edhe me LSI-në, që ai sërisht e etiketoi si simboli i vjedhjes së votave. "Kanë dalë në rrugë se nuk vijnë dot në zgjedhje, se po të vijnë në zgjedhje, dalin ashtu si hyjnë. Kanë dalë në rrugë dhe thonë ju blini votat. Një problem kishim si të ruajmë votat se do na i blejë fallxhorja. Nuk kemi pasur problem PD-në, por simotrën tonë, LSI-në. Dhe tani daja Titi këndon çdo ditë këngën të shpëtojme Shqipërinë nga ata që na blejnë votat. Shpëtojeni, shkoni në shtëpi dhe Shqipëria ka shpëtuar. Bëni provë, të rrijet LSI një turn pushim nuk ka blerje votash. Bëjeni pra!", - shtoi Rama.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të I (Pare), për shitjen e pasurisë së palajshme: Garazh, me sip. 96 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 16932-53, Vll. 45. Faqe 169, ndodhur në Linze Dajti, Tiranë, në promisi të Shoqërisë "KGLI" sh.p.k. identifikuar me NIF: JF17202046. Ankandi i pasurisë filon me çmimin fillestar në vlerën 1,893,120 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet) LEKë.

Ankandi do të zhvillohet më datë 26.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 131, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.
Ankandi të publikohet nga data 22.04.2019 deri më 26.04.2019

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

Përmbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat: me të dhenat: "Triut+Ndertes" me sip. totale 202.5 m² dhe nga kjo ndertes me sip.65 m², me Nr pasurie 7834, vll 58, fu 125, ZK 592 e ndodhur ne Lagjen Partizan, Shkoder.....e afishuar ne favor te debitorit Izmir Hebovja.

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar, është në vlerën: 9.120.000 (nëntemiliona e njëqind e njëzet mijë) lekë.
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 05.05.2019 ora 16.16 ne Zyrën e përmbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Tirana Bank dega Shkoder ne nr logarite 0600-313839-100 CB .

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

1.Përmbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat: "Ndertes ne jpkateshne industriale" me nr pasurie 1077ND, Volumi 24, Faqe 143, me sipfaqe ndertimore 1 235 m², Zona kadastrale 5592, e ndodhur tek zona industriale e cyetit ,pjesë e ish parkut te mallrave , Shkodere regjistruar ne favor te Altin Salihit etj

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar, është në vlerën: 24.240.000 (njëzetë kater miliona e dyqind e katerdhjetë mijë) lekë .
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 03.05.2019 ora 16.16 ne Zyrën e përmbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Tirana Bank dega Shkoder ne nr logarite 0600-313839-100 CB .

Publikohet tabela/Kategoritë e pagave dhe shtesat për nëpunësit e 'Agjencisë'

Tabela me pagat e reja për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Qeveria miraton rregullat e mbledhjeve dhe masat e shpërblimit

Miratohet tabela e pagave për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Punonjësit e ish-ALUIZNI-t dhe ish-Hipotekës do të trajtohen me një strukturë të re pagash. Ka hyrë në fuqi vendimi i qeverisë për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë për nëpunësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Kështu, drejtori i institucionit do të paguhet me pagë të kategorisë I-b dhe do të marrë 15 mijë shtesë për kushtet në punës. Ndërsa zëvendësytillari do të marrë pagë të kategorisë II-a dhe do të ketë një shtesë mujore për kushte në punë, në vlerën 20 mijë lekë në muaj. "Gazeta

SHPËRBLIMET
Këshillit Drejtues merr shpërblim mujor në masën 30 000 lekë, ndërsa anëtarët e Këshillit Drejtues marrin shpërblim mujor në masën 25 000. Anëtarët e sekretariatit teknik të këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 5000 lekë.

DREJTUESIT
Drejtori i institucionit do të paguhet me pagë të kategorisë I-b dhe do të marrë 15 mijë shtesë për kushtet në punës. Ndërsa zëvendësytillari do të marrë pagë të kategorisë II-a dhe do të ketë një shtesë mujore për kushte në punë në vlerën 20 mijë lekë në muaj.

Shqiptare" publikon tabelën e të pagave për të gjitha kategoritë e punonjësve në strukturën e ngritur rishitas. **VENDIMI**
Referuar vendimit të botuar në Fletoren Zyrtare, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij do të përballohen nga buxheti i ASHK-së si dhe nga buxheti i miratuar për vitin 2019 i Agjencisë së Legalizimit,

Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike. Sa i takon kategorizimit të drejtorive vendore, mësohet se kategoria e parë janë: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Vlorë, Fier, Kamëz - Vorë, Shkodër, Ko-

rcë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë; Krutë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës dhe Zonat e Stimuluar. Ndërsa në kategorinë e dytë janë: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë dhe Tepelenë. **RREGULLORJA**
Qeveria ka përcaktuar rregullat e funksionimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si dhe masën e shpërblimit për veprimtarinë e anëtarëve të saj. Si rregull, Këshilli Drejtues duhet të



Foto ilustruese

mblihet çdo muaj si dhe sa herë që kërkohet nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së, sipas nevojave të 'Agjencisë'. Sa i përket shpërblimit për veprimtarinë e anëtarëve, kryetari i Këshillit Drejtues merr shpërblim mujor në masën 30 000 lekë, ndërsa anëtarët e Këshillit Drejtues marrin shpërblim mujor në masën 25 000.

Anëtarët e sekretariatit teknik të këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 5000 lekë. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, të anëtarëve dhe të sekretariatit teknik të këshillit drejtues, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje përballohen nga buxheti i ASHK-së.

| POZICIONI | KATEGORIA | KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT | SHTESA PËR KUSHTE PUNE |
|---|-----------|---|------------------------|
| Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë. | III-a | 1 | 20.000 |
| Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë. | III-a/1 | 1 | 18.000 |
| Zëvendësytillari i drejtorive vendore të kategorisë së parë. | III-a/1 | 1 | 16.500 |
| Zëvendësytillari i drejtorive vendore të kategorisë së dytë. | III-b | 1 | 16.500 |
| Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | III-a/1 | 1 | 15.000 |
| Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | III-a/1 | 1 | 12.000 |
| Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | III-b | 1 | 15.000 |
| Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | III-b | 1 | 12.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | III-b | 1 | 15.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | IV-a | 1 | 15.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | III-b | 1 | 12.000 |

| POZICIONI | KATEGORIA | KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT | SHTESA PËR KUSHTE PUNE |
|--|--------------|---|------------------------|
| Titullar i institucionit. | I-b | 1 | 15.000 |
| Zëvendësytillari i institucionit. | II-a | 1 | 20.000 |
| Drejtor Njësie. | II-b | 1 | 15.000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes. | II-b | 1 | 20.000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë që lidhen me procesin e informatizimit. | II-b | 1 | 12.000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë e mbështetjes. | II-b | 1 | 12.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes. | III-a | 1 | 15.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët që lidhen me procesin e informatizimit. | III-a | 1 | 20.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës. | III-a/1 | 1 | 12.000 |
| Koordinator. | | | |
| Specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes. | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 15.000 |
| Specialist në pozicionet që lidhen me procesin e informatizimit. | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 20.000 |
| Specialist në drejtoritë dhe sektorët mbështetës. | IV-a IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 12.000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | IV-a | 1 | 12.000 |
| Titullar i Zyrës Vendore | IV-a | 1 | 15.000 |
| Specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes në drejtoritë vendore. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 15.000 |
| Specialist në zyrat vendore. | | | |
| Specialist në drejtoritë dhe sektorët mbështetës në drejtoritë vendore. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 12.000 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë**."

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 17 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BSH-FMN, takim për ecurinë e sistemit bankar

Fokusi i diskutimeve, kursi i këmbimit dhe kreditimi

kryesuar nga Jan Kees Martijn, shefi i misionit për Shqipërinë. Ky takim u zhvillua në kuadër të diskutimeve për Artikullin IV me misionin e FMN-së në vendin tonë. Çështjet e diskutuara gjatë këtij takimi ishin zhvillimet makroekonomike, pritshmëritë për vitin 2019 dhe përiudhën afatmesme, faktorët

e rritjes ekonomike, inflacioni dhe parashikimet për kthimin e inflacionit në objektivi, kursi i këmbimit dhe ecuria e tij, tregjet financiare, sistemi bankar, konsolidimi i tij dhe treguesit financiarë, mbikëqyrja bankare, ecuria e kreditimit dhe parashikimet për 2019-ën, kreditë me probleme, zbatimi i planit ndërinstitucional për reduktimin e tyre dhe masat që po ndërmerren në këtë drejtim, pritshmëritë për 2019-ën; paketa e deurozimit dhe masat përkatëse, modernizimi i sistemeve të pagesave. Në ditët në vijim, misioni i FMN-së do të zhvillojë takime me drejtues të lartë pranë Bankës së Sh-

qipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim diskutimin më në



Gubernuratori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë takimit me FMN

detaje të çështjeve të ndryshme lidhur me ecurinë e ekonomisë së vendit.

Shqiptarët paguan në një vit 14.5 miliardë lekë taksa vendore


Raporti, paratë që mbajnë në "këmbë" pushtetin vendor

Çdo qytetar shqiptar, një borxh prej 2418 lekësh

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në vitin 2018, taksat vendore kontribuan me rreth 59.7% në të ardhurat nga burimet vendore, raport ky rreth 4.8 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 64.5%). Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore regjistruan një nivel prej rreth 14.5 miliardë lekë, në rritje me rreth 14.1% në terma vjetorë. Të dhënat janë bërë publike në sot në raportin për situatën e financave vendore, prezantuar nga Co-PLAN. Raporti vë në dukje faktin se burimet financiare të shtuara bashkitë i përdoren për zgjerimin e shpenzimeve korrente (personel dhe operative). Në të kundërt, shpenzimet për investime (me fonde të veta dhe të kushtëzuara) u tkurrën gjatë periudhës në analizë. Ndërkohë, çdo qytetar shqiptar ka mesatarisht një borxh prej 2418 lekësh. Raporti i financave vendore për vitin 2018 nxjerr në pah pse stoku i detyrimeve të prapambetura të bashkive vijon të mbetet në nivele shqetësuese, ku për vitin që lamë pas u regjistrua në 6.8 miliardë lekë. Në nivel bashkie, detyrimet e prapambetura për frymë shënojnë vlerën maksimale në Konsipol me 13.755 lekësh dhe vlerën minimale në Maliq, me 57 lekë për frymë.

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në vitin 2018, taksat vendore kontribuan me rreth 59.7% në të ardhurat nga burimet vendore, raport ky rreth 4.8 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 64.5%). Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore regjistruan një nivel prej rreth 14.5 miliardë lekësh, në rritje me rreth 14.1% në terma vjetorë. Ndonëse në terma të përgjithshëm të ardhur nga taksat vendore rezultojnë të kenë shënuar zhvillime pozitive, një vështirim i hollësishëm mbi elementët përbërës evidenton dobësitë afatgjata apo varësinë ndaj



një numri të kufizuar takasash. Në tri vitet e fundit, performanca e të ardhurave nga taksat vendore është përcaktuar nga dy elementë: taksa e

ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja dhe taksat mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa, tokë bujqësore, truall). Ndërkohë që pe-

sha e kësaj të fundit është tkurrur, pesha e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja është rritur me ritme të

TAKSA

Të ardhurat nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja vijuan të rriten me ritme dyshifrore për të tretin vit radhazi. Në vitin 2018, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 7.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 39.4% në terma vjetorë, ose rreth 2.1 miliardë lekë më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm.

përshejtuar. Në vitin 2018, këto dy lloje takasash përfaqësuan 81.6% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Në të kundërt, pesha dhe kontributi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe taksat e tjera u tkurrën në vitin 2018. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet e kryera mbi të përbën një burim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor. Në tri vitet e fundit, të ardhurat nga kjo taksë vlerësohen në rreth 0.3% ndaj PBB-së nominale, raport ky ndjeshëm më i ulët krahasuar me mesataren e BE-së prej rreth 1.6% të PBB-së për vitin 2017 (NALAS 2019). Ndonëse ndër vite të ardhurat e mbledhura nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme kanë ndjekur përgjithësisht një rritje, problematikat

e lidhura me të drejtat e pronësive dhe mungesën e regjistrave kadastralë, ndër të tjera pengojnë shfrytëzimin e plotë të potencialit të kësaj takse. Në vijim të reformimit rregjësor të kësaj takse nëpërmjet Ligjit nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, 'Për sistemin e taksave vendore', të ndryshuar", fillimviti 2019 pritet të jetë dhe momenti kur të gjitha bashkitë në vend do të aplikojnë taksën e pronës sipas metodologjisë të re, bazuar në komunikimet në media të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

SHPENZIMET

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Shpenzimet e qeverisjes vendore përfaqësuan rreth 17.3% të shpenzimeve totale të qeverisjes së përgjithshme në vitin 2018. Deri në vitin 2015 ky raport nuk paraqet ndryshime të ndjeshme, duke u stabilizuar në një nivel mesatar prej rreth 13.7%. Në tri vitet e fundit, ky raport u përmirësua nga 15.9% në vitin 2018, si pasojë e rritjes së burimeve financiare totale të bashkive. Mesatarisht, në Shqipëri qeverisja vendore kanalizoi mbi 70% të burimeve financiare totale për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe rreth 30% për shpenzime kapitale.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,660,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të fërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:
 Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **17 Maj 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 Zyra përmbarimore "Best 2010" **SHPALLJE ANKANDI**

Zhvillim ankanidit e parë për pasuritë të be.in SHPK:
 1) a) nr.26/106+1-16, vol.51, fq.242, sip=72 m²; b) Njësi shërbimi nr.26/167-NB/2, vol 56, fq 121, sip=20 m²; c) nr.28/106+1-25, vol 52, fq 1-4; d) nr.26/187+1-9, vol 52, fq 58 (sipa=110 m²).
 2- Çmimi fillësor (për pasuritë e përcaktuara në pikën 1) për njësinë e shërbimit do të jetë 1600 euro/m², ndërsa për tre (apartamente) euro/m² e tjera do të jetë 360 euro/m².
 Pallati CO.BE.IN. VLORE (perballe Teatrit)
 Ankandi zhvillohet me dt.02.5.2019 pranë zyrës përmbarimore "BEST 2010"
 Me adresë: Selia; prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës
 Mobile: 06920 756 44, Phone/Fax: 052 22 6000
 Web: <http://www.permbarues.al> | www.permbarues.al

E.Sekiraga: U martova edhe 2 herë të tjera për të mos qëndruar në kampet e ISIS

KOSOVË

Duke iu bindur fjalës së burrit, E.Sekiraga thotë se kur ishte vetëm 19 vjeçe u nis për t'iu bashkuar kampeve të ISIS në Siri. Por, pas 5 viteve qëndrim, në moshën 23-vjeçare, ajo u kthye në Kosovë bashkë me dy fëmijët e saj. Burri i kishte vdekur në frontin e luftës. Në Siri, kjo 23-vjeçare kishte pasur edhe dy martesat të tjera. Të tre bashkëshortët e saj kishin qenë shqiptarë. Nga tri martesat, kjo 23-vjeçare ka dy fëmijë, me të cilët tashmë është kthyer në Kosovë. Ishte 19 vjeçe kur mori rrugën për në Siri, aty ku në vitin 2015 po zhvillohej një luftë e ashpër. Por, as lufta që bëhej atje nuk e ndali 23-vjeçaren E. Sekiraga dhe burrin e saj nga Prishtina që të niseshin për të dhënë pak "kontribut" në Lindjen e Mesme. Tmerri për të filloi në momentin kur ajo hyri në kampet e luftës. Aty 23-vjeçarja Sekiraga e pa se Siria nuk kishte qenë siç ajo e kishte paramenduar. Andaj që nga java e parë kur ajo u fut në kampet e luftës, thotë se i kishte kërkuar bashkëshortit të saj që të ktheheshin në Kosovë. Por, kjo gjë kishte qenë e pamundur. "Burri më thoshte po shkojmë në emrin e Allahut dhe nuk do të kthehem", - kështu ka deklaruar para avokates së saj, e rikthyera nga Siria për në Kosovë. Por, pas disa muajve qëndrim në kampet e luftës së Sirisë, E. Sekiragës i vritet burri. Ajo detyrohet që të martohet me një person të dytë, i cili kishte nënshpëtimin në shtetësi shqiptare. Por, edhe ai vritet në frontin e luftës. Burrin e tretë 23-vjeçarja e gjeti para pak kohë. Por, edhe ai u burgos para disa muajve. Këto dy martesat në Siri, E. Sekiraga ka deklaruar se i ka bërë vetëm që t'i shmanget qëndrimit në kampet e ISIS-it, aty ku qëndronin vetëm gratë dhe ku kushtet kishin qenë të mjerueshme. Këto detaje i dha avokatja e të riatdhesuarës, Fatlume Korqa. "Klientja ime që nga viti 2015 ka qëndruar në Siri. Ajo thotë se burri i ka kërkuar që të shkojnë në Siri për një jetë më të mirë. Siç ajo ka deklaruar, atje kanë shkuar për praktikimin më të lehtë të fesë. Edhe po të donte të kthehej, nuk do të mundë", - shpjegon ajo. "Bashkëshorti i saj i parë është vdekur në front. Pastaj ajo është detyruar të martohet prapë, sepse nëse nuk do të martohet, duhet të jetonte në një kamp me shumë gra, aty ku kushtet kanë qenë shumë të këqija. Andaj ajo u strehua të kurdët dhe nga aty u martua me burrin e dytë, që ishte shqiptar. Me të e ka pasur një fëmijë. Edhe ai ka vdekur. Edhe burri i tretë është shqiptar dhe për momentin gjendet në burg". Sipas avokates, klientja e saj është përduruar

Rrëfimi i 23-vjeçares së kthyer në Kosovë: Tri martesat dhe tmerri që pashë në Siri

"Burri që m'u vra pas disa muajsh më thoshte po shkojmë në emrin e Allahut dhe nuk do të kthehem"



Foto ilustruese

për rrugën që e ka marrë drejt Sirisë. Ajo kërkon që në Kosovë të jetojë e lirë dhe t'i rrisë të dy fëmijët e saj. Njërin 1 e tjetrin 3-vjeçar. "Ajo është përduruar që ka qëlluar në vendin dhe kohën e luftës. Por, thotë se nuk është përduruar që e ka dëgjuar fjalën e burrit të vet". "Kam ardhur në Kosovë që ndihem e lirë", - ka deklaruar e riatdhesuara, E. Sekiraga para trupit gjyqësor, shpjegon avokatja e saj. Për shumicën prej tyre, Prokuroria Speciale e Kosovës ka kërkuar një muaj paraburgim. Por, avokatet e këtyre grave janë duke kërkuar që masa e arrestit shtëpiak t'u zëvendësohet me paraqitje në stacionin policor. Gjykata Themelore në Prishtinë ka miratuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për vendosjen e masës së arrestit shtëpiak për 19 gratë e kthyera nga Siria. Gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur lidhur me dy kërkesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër të pandehurave, për shkak të veprës penale "Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës". Të pandehurave iu është caktuar masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj për secilën, duke filluar nga data 24.04.2019 deri me datë 24.05.2019. (Marrë nga "Gazeta Express").

23-VJEÇARJA

Tmerri për të filloi në momentin kur ajo hyri në kampet e luftës. Aty 23-vjeçarja Sekiraga e pa se Siria nuk kishte qenë siç e kishte paramenduar. Andaj që nga java e parë kur ajo u fut në kampet e luftës, thotë se i kishte kërkuar bashkëshortit të saj që të ktheheshin në Kosovë, por kjo gjë kishte qenë e pamundur.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur lidhur me dy kërkesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër të pandehurave, për shkak të veprës penale "Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës".

VRASJA E 2 BURRAVE

E.Sekiragës i vritet burri. Ajo detyrohet që të martohet me një person të dytë, i cili kishte nënshpëtimin shqiptarë. Por, edhe ai vritet në frontin e luftës. Burrin e tretë 23-vjeçarja e gjeti para pak kohë. Por, edhe ai u burgos para disa muajve. Këto dy martesat në Siri, E.Sekiraga ka deklaruar se i ka bërë vetëm që t'i shmanget qëndrimit në kampet e ISIS-it, aty ku qëndronin vetëm gratë dhe ku kushtet kishin qenë të mjerueshme. Këto detaje i dha avokatja e të riatdhesuarës, Fatlume Korqa.

Ngritën laborator droge në Shqipëri, 3 amerikanët dalin para gjyqit në SHBA

SHBA - Pasi u arrestuan në Shqipëri dhe u ekstraduar drejt SHBA-ve, Arbër Isaku dhe Vincent Decaro si edhe David Reichard po përballen me akuzat për prodhimin e drogave sintetike dhe trafikimin e tyre. Ata u paraqitën në gjykatën e qarkut të Bridgeport të mërkurën dhe sipas avokatit të SHBA-ve për Connecticut, John Durman, ata u njohën me akuzat për prodhimin të pilulave që përmbajnë fentanilin nga Kina dhe shitjen e tyre në tregun e zi. Sipas aktakuzës, pilulat u shitën në tregun e zi, teksa Reichard ndihmonte Decaron dhe Isakun për përgatitjen e pilulave dhe më pas dorëzimin e tyre të klientët. Më 3 prill të vitit të kaluar, një autorizim i gjykatës për kontrollin e banesës së Decaror-s, çoi në konfiskimin e pilulave, rreth 330 gram fentanil dhe acid fentanil, 40 gramë pluhur analoge



me fentanil, instruksione sesi të përgatiten pilulat, maskë kundër gazit si edhe një sërë zarfesh poste amerikane. Në kohën kur policia kontrollon shtëpinë e Decaror-s në prill të vitit të kaluar, Decaro dhe Isaku ishin në Evropë. Ata janë arrestuar që nga 21 shtatori i vitit të kaluar nga policia shqiptare, ndërsa po përpqeshin të kalonin kufirin nga Shqipëria në Kosovë. Durham tha se gjatë kontrollit të një apartamenti në

Tiranë ku ata kishin qenë qëndruar, u zbuluan disa substanca për përgatitjen e pilulave si dhe instruksionet e nevojshme. Ndaj tyre rëndojnë akuzat për posedim dhe shpërndarje të substancave narkotike, duke rrezikuar minimumi 10 vite burg. Teksa ndaj Isakut rëndon edhe një tjetër akuzë për posedim të qëllimshëm të substancave si fentanil dhe analogë të saj, duke rrezikuar deri në 20 vite burg.



Ekstradohet nga Greqia i dënuari me 16 vite burg

për tentativë vrasjeje

GREQI - Dy shqiptarë të akuzuar dhe të dënuar në vendin tonë janë ekstraduar nga Greqia nga Interpol Tirana, një prej të cilëve i dënuar me 16 vjet burg. Konkretisht, nga specialistët e Interpol Tirana u krye ekstradimi nga Athina/Greqi drejt vendit tonë, i shtetasit shqiptar Ali Toskaj, 36 vjeç, lindur në Fier. Mësohet se Toskaj ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Z.Q.K Interpol Tirana, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin në vitin 2017 e ka dënuar me 16 vite burg për veprat penale "Vrasje me dashje, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë", "Vjedhje me armë" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarakë dhe municioneve". Gjithashtu, po nga specialistët e Interpol Tirana u krye ekstradimi nga Athina drejt vendit tonë i shtetasit shqiptar G.B., 48 vjeç, pasi autoritetet greke të drejtësisë kanë miratuar ekstradimin e tij drejt vendit tonë. Shtetasi G.B. ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Poqradec në vitin 2017 ka caktuar masën e sigurisë "arrest me burg" për veprën penale "Dhunë në familje". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Interpol Athinë u bë i mundur arrestimi i tyre në Greqi, duke u finalizuar me ekstradimin drejt vendit tonë. Gjatë katër muajve të parë të këtij viti, Interpol Tirana ka ekstraduar disa persona nga vende të ndryshme të Europës, të akuzuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale.

TIRANË - Hetimet për zbardhjen e megagrabitjes në Rinas janë në vijim e sipër. Ndërsa deri më tani janë pesë të arrestuarit që kanë lidhje me ngjarjen, policia ka thirrur për të dëshmuar edhe bashkëshorten gjermane të njërit prej tyre. Bëhet fjalë për gruan e Renaldo Sulës. Nuk dihet lidhja që mund të ketë kjo e fundit me ngjarjen, por mësohet se shtetësia gjermane ka dhënë dje dëshminë e saj. Bashkëshorti i saj, 25-vjeçar nga Elbasani, Renaldo Sula, u



Policia rrethon Krujën, bastis banesat e Veselit e Piklit

Grabitja, merret në pyetje gruaja gjermane e Renaldo Sulës

la dy ditë më parë nën masën "arrest me burg" nga Gjykata e Krimeve të Rënda së bashku me Saimir Çelën dhe Olion Veselin. Një ditë para tyre, edhe për dëshmitarin e drejtësisë, Alkond Bengasin gjykata dha të njëjtën masë. Të mërkurën policia bëri me

dije se po heton një ish-polic, 31-vjeçaren E.Bici, e cila dyshohet të ketë djegur furgonin e tretë të përdorur për grabitjen e 9 prillit në afërsi të Bathores, me qëllim shpërqendrimin e vëmendjes së policisë. Ndërkaq, ditën e forca të

shumta policie kanë mësyre drejt Krujës e Fushë-Krujës, vende ku ndodhen edhe banesat e Olion Veselit e Elton Piklit, dy prej të arrestuarve si pjesë e bandës që grabitën rreth 6.5 milionë euro në aeroportin e Rinastit më 9 prill. Burime për

"GSH" bënë me dije se janë kontrolluar banesa e Veselit në lagjen "Çitoze" të Krujës dhe banesa e Elton Piklit në lagjen "Abaze" të Krujës, por edhe në dyqanin ku ai punonte si kasap në qendër të qytetit të Krujës. Gjithashtu, kontrole janë ushtruar edhe në disa banesa të disa personave të tjerë të dyshuar. Për kontrollin e banesave dhe ambienteve janë përdorur qen, por edhe metal detektor. Nuk dihet nëse janë gjetur sende, para apo prova të tjera gjatë këtyre kontroleve blic dhe të intesishëm.

Reagon Kaçori: S'mendoj se kenim mundësi për të më bërë dhe mua banor të përkohshëm të burgut

Klodiana Lala

Takimet me të dënuarit VIP, fusin në sherr krerët e Burgjeve, zbardhen emaillet

Drejtori i Përgjithshëm, Agim Ismaili paralajmëron me burg zyrtarët e IEVP-ve

TIRANË
Përplasja të forta mes krerëve të Burgjeve. "News24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë siguruar emaillet zyrtare të shkëmbyera mes Drejtorit të Përgjithshëm, Agim Ismaili dhe atij të Policisë, Bardhul Kaçori. Emailin e parë në adresë të Kaçorit dhe drejtuesve të IEVP-ve në vend e dërgon Ismaili, i cili e mori drejtimin e institucionit pas largimit të Stefan Cipës.

Në emailin që disponon "GSH", ndër të tjera, Ismaili flet për takime të padokumentuara të zyrtarëve të burgut me të dënuar VIP. Këto zyrtarë ai i paralajmëron me burg.

EMAIL I AGIM ISMAILIT

"Kam informacion që nga drejtues e funksionarë kryhen takime jo institucionale dhe të padokumentuara me të burgosur të caktuar, kryesisht VIP. Varianti i menaxhimit të burgut, ruajtjes së qetësisë e normalitetit aty, përmes kreditimit e trajtimit preferencial të VIP-ve është efektivisht një transferim i pushtetit të administrimit të burgut tek ata. Çdokush që i takon konfidencialisht ka kryer një shkelje shumë të rëndë dhe goditje të fortë ndaj punonjësit të policisë, i cili gjatë këtyre takimeve të shëfave rri si kaqol mbas dëre. Ata janë të burgosur si gjithë të tjerët, respekti ndaj integritetit të tyre e lirive e të drejtave të parashikuara në aktet rregullative është busula e vepimit tonë, por takime jo institucionale, konfidenciale, të padokumentuara përbëjnë një akt që nuk ka lidhje me detyrën, por edhe drejtpërdrejt kundër saj.

Të burgosurit janë të barabartë pavarësisht krimit të kryer forcës fizike, fuqisë ekonomike, mbështetjes kriminale apo ndryshe nga jashtë burgut. Nëse nuk i trajtojmë kështu, efektivisht jemi bërë pjesë e suportit ndaj tyre dhe efektivisht duhet të jemi aty me ta (në burg) e jo duke qeverisur burgun. Është e evidente sesa i motivuar do jetë një polic, apo oficer trupe përballë të burgosurve VIP gjatë veprimeve që kryhen për ditë, ndërkohë që x apo y drejtor i takon konfidencialisht ata?

Çfarë ju thotë ky drejtor? Ku e dokumentoni veprimin? Çfarë zgjidhni?

Do marr masa për të veri-

fikuar raste kësajsoj dhe padyshim që reagimi im do jetë "propozim për shkarkim", por ky është vetëm fillimi".

I menjëhershëm ka qenë reagimi i drejtorit të Policisë së Burgjeve, i cili informon Ismailin se ka vepruar konform ligjit, duke dëgjuar nga afër problematikat e të dënuarve. Kaçori i përgjigjet edhe kërcënimit të eprorit të jem me ta (në burg), pavarësisht eksperiencave negative që kanë ndodhur me Drejtorët e Përgjithshëm (nënkupton Arben Çukon, i cili u arrestua pas dyshimeve për korrupsion shën.redaktor), fatkeqësisht kohë e fundit. Nuk mendoj se ju e keni këtë mundësi për të më bërë edhe mua banor të përkohshëm të ndonjë IEVP për shumë arsye", shkruan Kaçori.

EMAIL I PLOTË I BARDHUL KAÇORIT

"Në përgjigje të informacionit të përcjellë nga persona anonim dhe pa karakter dhe vazhdimisht tek ju për takimet VIP (të cilët i cilësoj në mënyrë të përsëritur të tillë) dhe i unani jo institucionale, ju bëj me dije se: Nuk quhen takimet, por kontakte me të dënuarit, se janë të paparashikuara pavarësisht problematikave që ata i kishin përcjellë para shumë kohësh. Varianti i menaxhimit të burgut përmes kreditimit e trajtimit preferencial ka të bëjë me shumë me paafësinë për t'u përballur Ju dhe ndonjë



Faksimil e emailve

tjetër me këta VIP-a për problematikat që ata kanë dhe i shprehin në mënyrë të tyre kur rregulli ja parashikon dhe mospërballja me to ju jep kredite dhe autoritet fals. Unë gjithmonë i trajtoj të dënuarit të barabartë në të drejta dhe zbatueshmëri ligjore. Takimet konfidenciale nuk arrija t'i kuptoj në këtë email, kur unë shoqërohem nga një staf policor si çdo person tjetër që ligji lejon hyrjen në IEVP pa autorizim, mos vallë ju duhet të më autorizoni mua për të bërë detyrën time dhe më shumë tuajën për këto kohë? Nuk dëshiroj të jem me ta (në burg), pavarësisht eksperiencave negative që kanë ndodhur me Drejtorët e Përgjithshëm, fatkeqësisht kohë e fundit. Nuk mendoj se ju e keni këtë mundësi për të më bërë edhe mua banor të përkohshëm të ndonjë IEVP për shumë arsye. Për sa i përket motivimit të punonjësve ato shohin vazhdimisht aftë-

sinë time për t'u përballur në mënyrë të drejtpërdrejtë duke argumentuar me zë të lartë të drejtat dhe detyrimet me persona të cilët janë problematikë në shumë aspekte, ku takimet e mia janë dhe të orientuara shumë herë nga ata si një nevojë për t'u dhënë autoritetit të gjithë punonjësve.

Ky, Drejtori ju thotë atyre që do drejtoj me mend, me qetësi, pa korrupsion, me korrektesë, barazi dhe trimëri. Që të mos lodhesh duke verifikuar kontaktet e mua, po ju listoj të gjithë personat që takova sipas informacionit tuaj anonim: Alfred Shkurti, Enver Dondolaku, Viktor Imeri, Denis Shtraza, Selman Myrto, Astrit Pegini, Eduart Peqini, Altin Kodra, Gazmend Braika, Agim Pepa, Fredi Aliaj, Armand Hasani, Dritan Dajti, Hektor Voci, Klajdi Sherrmadji, Arben Grori, Dritan Kateshi, Taullant Balliu, Alfred Qefalia, të gjithë të dënuar të sigurisë së lartë.

Ndërsa super VIP-i ishte Dejvis Rustemi, i cili më ngatërroi me Drejtorin e Përgjithshëm duke me kërkuar konfidencialitet pasi po fliste me një nipin tuaj në telefon me mbiemrin Bushati (nëse është i vërtetë).

Drejtor paraprakisht duhet të konsultoheshe me mua, përpara se të përcillje email-in. Ju akuzoni padrejtësisht, kërcënoni padrejtësisht, ofendonin padrejtësisht. Unë kisha shumë gjera për Ju dhe të tjerë, por mendoj pas një periudhe 3 mujore, Ju detyrimisht do ta ndryshoni këtë STIL pune si një periudhë stanjacioni, pasi burgu nuk është magazinë kavanozësh, por një jetë me problematike ku zgjidhjet priten më shumë nga ju, përveç stuhisë nëdëshkimore që po kalojmë me shumë dhimbje dhe stres. Nuk di sa sintetik ishte me këtë përgjigje. Por të garantoj vetëm sinjeritet për sa të shkuajta".

Të tjera emaille janë shkëmbyer mes dy krerëve të burgjeve, të cilët në vend që të menaxhojnë situatën në të gjitha IEVP në vend, që për hir të vërtetës sigurinë të të shumës për të dëshiruar dhe ka një mal probleme, për shkak se shumë të dënuar VIP bëjnë ligjin brenda mureve, harxhojnë kohë dhe energji duke kërcënuar njëri-tjetrin me burg, apo etiketuar policët si "kaqol" apo institucionin si "magazinë kavanozësh".

Vdekja e gruas pas lindjes, familjarët sërish në protestë: Kërkojmë drejtësi

ELBASAN - Me pankarta në duar dhe thirrje si: "Duam drejtësi", "e lanë të vdehtë" apo "Kush do t'i japë gjë Aleas, familjarë, miq dhe të afërm të 25-vjeçares Rexhina Debrova protestuan sërish ditën e djeshme para maternitetit të Elbasanit. Në protestë dolën edhe shumë qytetarë, të cilët iu përgjigjën ftesës së familjarëve. Këta të fundit fajtojnë mjekët e spitalit për humbjen e njeriut të tyre të dashur. 25-vjeçarja ndërroi jetë 1 orë pasi lindi foshnjën. "Edhe unë mund të isha Rexhina" dhe "sa vlejme në nënat", shkruhej në disa prej pankartave që mbanin në duar protestuesit. Ata mbajtën 1 minutë heshtje dhe më pas ndezën qirin në trotualet pranë maternitetit, nga ku 25-vjeçarja ndërroi jetë. Rexhina Debrova, humbi jetën 3 ditë më parë, vetëm një orë pasi kishte sjellë në jetë vajzën e saj. Protestës së familjarëve i janë bashkuar edhe gra e vajza të Elbasanit, ndërsa para kamerave, mikësha të 25-vjeçares premtuan se do t'i japin Aleas së vogël, të gjithë dashurinë që nëna e saj nuk mundi t'i japë dot. Kjo protestë pason atë të një dite më parë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kur trupi gjykoës vendosi të lirojë me masën "detyrim paraqitje" dy mjekët e arrestuar nga policia deri në përfundim të ekspertimit mjeko-ligjor.

Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbartimore L.D.C

-Nr. pasurisë 50/1, ZK Vriua, vol 1, fq 27, Truall me sip. 240.47 m² + ndërtesa me sip. 240.47 m². Regjistruar ne ZVRPP Gjirkaster ne emer te Fatos Çela. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.445.600 Leka.

-Nr. pasurisë 190/84, ZK 2647, vol 2, fq 247, Truall me sip. 300 m² + ndërtesa një katëshe me sip. 88 m². Regjistruar ne ZVRPP Tepelene ne emer te Votim Çela. Çmimi fillestar per shitje eshte 1.064.000 Leka.

Data e shpalljes 09.04.2019

Data e zhvillimit 08.05.2019 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Mystyl Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shitje me Ankand te Dyte nga Studio Permbartimore L.D.C

"Truall" me sip. 1.874m² nga e cila 250 m² eshte ndërtesa, me Nr. Pasurie 134/33, vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier. Regjistruar ne Z. R. P. Fier ne emer te Shoaq Allajon shpk. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.180.854 Leka.

Data e shpalljes 02.04.2019

Data e zhvillimit 07.05.2019 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Mystyl Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

"EPIRI I VERIUT" DOSSIER

Zyrtarizimi i platformës shovene helene "Megali Idea"

Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorioepirote

Zografi kërkoi që edhe Lunxhëria të shpallej zonë pakice greke



Dr. Hasan Luçi

Ngjarja e 28 tetorit 2018 në Bularat, ku terroristi ush tarak ekstremist grek qëloi pa ngurrim kundër forcave të policisë dhe RENEAs, dhe megjithëse u bisedua me të dhe iu bë thirrje të dorëzohet, ai u përgjigj me breshëri dhe kreu misionin e ngarkuar nga qarqet përkatëse, prandaj u vra sipas ligjit shtetëror kudo në botë. Ky andart i ri kreu provokacionin e radhës armiqësor të programuar me të pikërisht në këtë rast festiv, me pjesëmarrje të autoriteteve greke si Ministria e Kulturës, deputetë të "Agimit të Artë" fashist dhe deputetëve të pakicës greke, për të propaganduar si gjithmonë "Idenë e madhe" greke, ndoshta me mendimin se policia shqiptare nuk do ta vriste, siç ka ndodhur edhe herë tjetër.

Më poshtë do të bëj një historik të shkurtër të kësaj lëvizjeje të vjetër dhe të përshatur në kushtet e reja të organizmave greke zyrtare e private, që i financojnë e drejtojnë grupet e bandat e përfshira në këto veprimtari të ndryshme antishqiptare, tashmë dy shekuj. Në këtë shekull të tretë kjo lëvizje "vorioepirote" ka tashmë shtrirje legale në Shqipëri për shumë arsye që i lejoi tranzicioni demokrat shqiptar dhe qëndrimi përulës e tolerues i qeverive shqiptare dhe gjoja "të drejtat" e fituara nga pakica greke, të cilës i janë lënë hapësira vepruese që përbëjnë ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit shqiptar, me

dhe pa dorën zyrtare të qeverive greke apo organizmave private shovene grekomëdha.

Lëvizja "vorioepirote" ka lindur nga lakmitë imperialiste helene në Ballkan, e cila është thelbi i platformës politike agresive e "Megali Idesë". Qysh me shpalljen e pavarësisë së Greqisë nga Perandoria Osmane në 1821, qarqet e nacionalizmit ekstrem helen filluan të ëndërojnë ringritjen e perandorisë bizantine dhe hartuan plane për t'i zgjeruar kufijtë e Greqisë. Ende pa u zyrtarizuar fitorja e plotë e lirisë e pavarësisë më 1830 u bënë edhe plane për krijimin e një federate Greqi-Shqipëri, ku vulën do ta kishte Greqia pa ndonjë kufi autonomie, pasi edhe disa bejlerë shqiptarë u mbështetnin orësket panhelene.

Sipas shovenëve grekë, quhen "vorioepirotë" të gjithë njerëzit ortodoksë brenda e jashtë Shqipërisë, të cilët kanë origjinën e tyre ose janë nga territori i Sh-

qipërisë së Jugut, i ashtuquajtur prej tyre "Vorio Epir" (Epir i Veriut), pasi sipas tyre, edhe Pirro i Epirit, strategu i mirënjohur në histori qenka helen (Enciklopedia Britanica, "Epirus" 2013).

Më 1844 u zyrtarizua platforma shovene helene "Megali Idea" (Ideja e madhe), e cila planëzoi shtrirjen e kufijve të Greqisë nga gjiri i Burgasit në Detin e Zi dhe deri në Shkodër në detin Adriatik. Kjo ide është skalitur në ballonen e parlamentit grek, ku lexohen lehtas krahinat shqiptare të përfshira, mbi palikarët grekë që bëjnë roje me fustanellën shqiptare. Mbi këtë platformë u planëzuan mëtimet për t'i përfshirë trojet shqiptare nën mbretërinë greke, në mënyrë të njëpasnjëshme kohë pas kohë, në përshtatje me zhvillimin e ngjarjeve në Ballkan kundër perandorisë së "sëmurë" të Bosforit. Përfshirja në Greqi e trojeve shqiptare do të justifikohet me rimarrjen e "trashëgimisë osmane", që

gjoja paskësh pushtuar Epirin antik grek. Kështu nisi krijimi, organizimi dhe praktika ushtarake greke dhe e bandave të lëvizjes "vorioepirote". Qysh në 1854 filluan sulmet e bandave të Grivas në territoret shqiptare për t'i përzënë banorët prej tyre. Më 1878 u bë zbarkimi ushtarak grek në Lëkurës të Sarandës, ku ata pësuan disfatë të plotë nga forcat shqiptare, nën drejtimin e nën prefektit të Himarës, Myslim Gjolekës, të birin e të mirënjohur Zenel Hito Gjoleka, kryekomandant i kryengritjes së Tanzimatit më 1847. Me luftëra të përkohshme, me ndalimin e gjuhës shqipe e hapjen e shkollave greke e kishave greke, me vrasjen e atdhetarëve e priftërinjve mësuës vijoi përballja me Greqinë mbretërore, me mbretër nga fuqitë e mëdha si Otoni gjerman. Pas tij kancelari gjerman, Bismarku deklaroi se Shqipëria qenkej vetëm shprehje geografike.

Babai i shovinizmit grekomadh, Eleftheris Venizellosi, ende pa u përcaktuar kufijtë mes Shqipërisë e Greqisë nga Fuqitë e Mëdha, ndërhyri ushtarakisht, pushtoi Janinën më 1913 dhe Shqipërinë e Jugut deri në Himarë-Berat. Gjenocidi shoven grek shkretoi jugun e Shqipërisë dhe një pjesë e popullsisë shpëtoi në ullishtat e Vlorës, nga ku u kthye nga 1916 për ta rindërtuar jetën nga e para. Edhe sot Greqia s'e ka dënuar këtë gjenocid e as ka kërkuar të falur. Për qëndresën shqiptare që gjeti Venizellosi deklaroi: "Le të jetë një cikël Shqipëri po mos ketë Labëri", ku theu jo pak hundët. Edhe Napolon Zerva deklaroi "Le të jetë sa të dojë Shqipëria, Labëri mos ketë!"

Pasi u caktuan kufijtë e Greqisë në dem tragjik të trojeve shqiptare më 1913 nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Greqia rivlerësoi dhe u dha kërkesa të reja "vorioepirotëve", duke e vetëquajtur si lëvizje për aneksimin e Epirit të Veriut dhe bandat andarte greke filluan sulmet. Lufta për kaktimin e kufijve ka qenë e rreptë, pasi grekët bënë shumë mashtrime me miqtë dhe me agjenturat e tyre vendëse.

Lëvizja "vorioepirote" përbëhet nga dy rryma shovenësh: njëra ekstreme mëton të gjithë territoret




in shqiptar që shtrihet në jug të lumit Shkumbin si minimum dhe maksimum deri në lumin Mat, tjetra e moderuar mëton territoret Korçë, Kolonjë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë dhe krahinën e Himarës.

Pushtimi i Shqipërisë Jugore nga Greqia më 1912-1913 cenoi interesat e Fuqive të Mëdha e të satelitëve fqinjë, në radhë të parë të Serbisë, Italisë e Malit të Zi. Italia mëtonte prej kohe pjesën jugore shqiptare nga Sazani, Vlo- ra, Tepelena, Gjirokastra deri në Sarandë. Musolini e donte Sarandën "Porto Eda", ndërsa Greqia e mëtojnë që nga lufta e Lëkurësit në 1878, kur kthyen qafën nga Labëria.

Rivaliteti mes fqinjëve tanë dhe miqve të tyre të mëdhenj bëri që të nënshkruhej mes Fuqive të Mëdha "Protokolli i Firences" në dhjetor 1913, në Itali. Kështu u krijua komisioni për saktësimin tragjik të kufijve të Shqipërisë, megjithëse brenda të cilëve u përfshinë edhe qyteti i Korçës e Gjirokastër, por fundi nuk dihej. Mbi këtë bazë fuqitë e mëdha i dërguan Venizellos ultimatumin për t'i tërhequr menjëherë trupat ushtarake dhe bandat nga Shqipëria e Jugut deri në kufijtë e përcaktuar nga "Protokolli i Firences".

Por, ky ultimatum u prishte të gjitha planet shovene të qeverisë së Venizellosit, i cili në fillim u detyrua të zbatonte ultimatumin dhe të tërhiqte nga territori shqiptar. Por, ai dredhloi dhe nuk hoqi dorë nga mëtimet e tij, duke ndryshuar taktikën e strategjisë armiqësore ndaj Shqipërisë. Venizellosi e përkrahësit e vet nxitën, organizuan dhe financuan të ashtuquajturën "Lëvizje Autonome Vorioepirote" në Shqipërinë e Jugut. Në mënyrë mashtruese, kjo lëvizje u quajt si lëvizje "vorioepirote" e pavarur nga qeveria greke. Në fakt, repartet e ushtrisë greke sulmuese përbëheshin nga oficerë e ushtarë të ushtrisë së rregullt greke, të veshur si civilë që u quajtën "vorioepirotë". Në



Eleftheris Venizellos



Forcat greke në Shqipërinë e jugut

këtë lëvizje u përfshinë edhe banditë e kriminelë, të cilët u liruan me kusht nga burgjet greke për t'u bërë mish për top për Greqinë.

Më 1914 u shpall publikisht në Gjirokastrë "Autonomia e Vorio-Epirit", pasi u mbajt kongresi i lëvizjes "vorioepirote". Në këtë autonomi përfshiheshin krahinat e Korçës, Gjirokastrës e Himarës. U krijua edhe qeveria e përkohshme vorioepirote me kryetar Kristaq Zografon nga Lunxhëria e Gjirokastrës. Gjithashtu, tradhëtari ushtarak grek, Spiro Milo, nga Himara, i cili kishte zbkruar më herët në Himarë me bandat e ushtarë grekë, shpalli autonominë e Himarës. Në fakt, ai i kishte filluar sulmet ndaj Kurveleshit edhe me plotë grekomanët himarjotë në vijën frontale Llogora-Kuç-Borsh. Kundër agresorit himarjot grekomadh u bë edhe Kuvendi i Katundit në Kuç nga popullsia e Kurveleshit, Lumit të Vlorës etj., për t'i bërë ballë agresionit grek, me porositet e Ismail Qemalit. Zografo kërkoi që edhe Lunxhëria të shpallej zonë pakice greke, se ia paskësh lënë babai ndofsha.

Më 14 maj 1914 qeveria e Venizellosit dhe ajo e Zografos, me nxitjen, përkrahjen e ndihmën e fuqive të mëdha, nënshkruan "Protokollin e Korfuzit", si një marrëveshje që vultose të drejtat dhe aneksimin e trojeve shqiptare të Shqipërisë së jugut, në mënyrë të tërthortë si kërkesë popullore etnike ortodokse, duke i njohur Greqisë mëtimet mbi "Vorio Epirin", gjë që pasqyrohet qartë në këtë protokoll, me këto vendime konkrete, veç të tjerave:

- Të lejohej përhapja e kulturës greke, jo vetëm në pakicën greke në jug, por edhe në radhët e popullsisë ortodokse shqiptare, e cila quhej "vorioepirote".
- Të lejohej përhapja e mësimi i gjuhës greke në të gjitha shkollat e krahinat e Shqipërisë së jugut, në të cilat do të shërbenin arsimtarë të dërguar nga Greqia.
- Kisha shqiptare të varej direkt nga Patriarkana greke e Stambollit dhe ceremonitë fetare të bëheshin vetëm në gjuhën greke.

Në konferencën e Korfuzit, ku u nënshkrua protokollin mori pjesë edhe delegacioni shqiptar i dërguar nga qeveria e princ Vedit, me kryetar Mehdi Frashërin, i cili ra plotësisht në grackë dhe përkrahu vendimet, që u morën atje kundër lirisë e pavarësisë së shtetit të cunuar tragjikisht shqiptar dhe kombit tonë. Sipas këtij protokollin, në Shqipërinë e Jugut do të zbatohet një regjim i posaçëm dhe jo ai i shtetit shqiptar, pasi i lejohej qeverisë greke fushë e lirë vepruese për të ndërhyrë në punët e brendshme shqiptare, nën shkakun e kujdestarisë për problemet në jug të vendit.

Ky "Protokoll i Korfuzit" për "Autonominë e Vorioepirit" u njoh nga fuqitë e mëdha dhe nga "Traktati i Londrës" të 1915, që u përdor e përdoret ende nga qeveritë greke edhe sot me synimet e praktikën e tyre diplomatike me Shqipërinë si argumente për të justifikuar e mbajtur gjallë praktikisht e juridikisht mëtimet territorialit greke në Shqipëri.

Duke përfutur nga statusi i veçantë mbi këto baza "juridike", me përkrahje të fuqitë të mëdha, qeveria greke nxitoi, ndërmori dhe organizoi një rrjet të gjerë agjenturor, jo vetëm përmes konsullatave greke të shumta në jug (Gjirokastrë, Berat, Sarandë, Durres, Shkodër), por edhe përmes mësuesve e priftërinjve të shumtë që ndodheshin apo u dërguan men-

jëherë nga Greqia në Shqipëri. Priftërinjtë grekë vepruan me shpejtësi për ta shtuar e nxitur këtë rrjet agjenturor në çdo drejtim antishqiptar.

Për ta drejtuar në mënyrë të organizuar e të centralizuar lëvizjen "vorioepirote", qeveria greke krijoi më 1918 "Komitetin Qendror të Përpjekjeve Vorioepirote" (QEVA), si organ drejtues, bashkëpunues e bashkëveprues për të zbatuar politikën e aneksimit të trojeve shqiptare. QEVA bëri plane, nxiti e drejtoi veprimtarinë e gjithanshme brenda e jashtë Greqisë në diasporë. Me vendimet e këtij komiteti u krijuan edhe brenda territorit grek, sidomos në zonën e Epirit si Janinë, Follorinë, Korfuz etj., një seri degësh "vorioepirote", me qëllim që kjo lëvizje për aneksimin e "Vorioepirit" të shtrihej e zgjerohet në gjithë Greqinë e në diasporë. Degë të QEVA-s u krijuan edhe brenda territorit shqiptar si në Përmet, Gjirokastrë, Korçë, Sarandë, Himarë, Vlorë etj. Këto degë merreshin jo vetëm me veprimtari propagande kundër Shqipërisë, por kryesisht me veprimtari spiunazhi, terrori, veçanërisht kundër atdhetarëve shqiptarë, që punonin e luftonin për ruajtjen e gjuhës shqipe, të fesë shqipe, për mbrojtjen e trojeve tona nga copëtimi i mëtejshëm tragjik i fuqive të mëdha, që kënaqën vendet fqinjë.

Me vendimet e Konferencës së Paqes në Paris më 1919, pas Luftës

së Parë Botërore, me Luftën e Vlorës më 192), protokollin e ri më 1920 dhe me njohjen e kufijve më 1921 nga "Protokollin i Firences", siç u caktua nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, u goditën pjesërisht disa plane të mëtimeve të mëtejshme të fqinjëve ndaj trojeve shqiptare, por mbeti jashtë varrit litari i "Nastradinit", rrjeti agjenturor edhe në familje të mëdha shqiptare për orekset glabëruese të fqinjëve tanë, që historikisht nuk kanë pësuar ndonjë agresion nga shqiptarët, veç mbrojtjes së territoreve etnike natyrore historike.

Në vitet 1920-1940, megjithëse qeveritë shqiptare e njohën pakicën greke zyrtarisht, qeveria greke vijoi veprimtarinë armiqësore ndaj Shqipërisë përmes QEVA-s, me forma e metoda të ndryshme. Gjatë kësaj kohe, Greqia e rriti veprimtarinë agjenturore për të studiuar, përgatitur dhe ngritur baza të reja armiqësore agjenturore për të krijuar kushtet e favorshme për realizimin e qëllimeve aneksoniste, duke nuhatur luftën e ardhshme. Në 1925-1926, A.Zogu lidhi 4 marrëveshje me qeverinë greke, e cila synoi të krijonte federatën e ëndërruar, por në vitet 1930 u godit duke mbyllur edhe shkollat greke, pasi Greqia kaloi çdo kufi me ndërhyrjen në punët e brendshme shqiptare.

Qysh më 1940, pasi u shpartalua në frontin grek ushtria italiane agresore ndaj Greqisë, ushtria greke hyri në territoret shqiptare në Korçë e Gjirokastrë, Kurvesh, Lumin e Vlorës, Llogora. Kështu, Greqia ringriti e rifuqizoi më mirë punën e saj, sidomos në trojet shqiptare të pushtuara. Ajo jo vetëm ripërritri rrjetin agjenturor, që pjesërisht ishte goditur nga regjimi i A.Zogut e pushtuesit italianë, por krijoi edhe bërthamën e pushtetit grek në këto krahina. Ushtria greke bëri dëme të mëdha ekonomike e mjedisore në tokat e pushtuara, veç internimeve në ishujt grekë të atdhetarëve që iu kundërvunë veprimeve antishqiptare në vend. Për veprimtari të tillë jam dëshmitar, megjithëse fëmijë, se fronti u ndal edhe në territorin ku banoja unë në Kuç të Labërisë dhe ushtria greke nga rrëmbu në 1941 tërë koponë e dhenve e dhive pa asnjë pagesë, veç kafshët e ngarkesës, si gjithë krahinës dhe më gjerë....



(vijon nesër)

NDIHMJA EKONOMIKE PËR FITUESIT

Shërbimi Social Shtetëror: Kujdes, duhet të paraqiteni çdo 3 muaj që të mos penalizoheni

Voltiza Duro

Të gjithë ata persona apo familje që plotësojnë kriteret e paraqitura mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot 6 kategoritë që iu lënd drejta të marrin pagesën si dhe kriteret e dokumentacionin që duhet të plotësojnë të interesuarit.

KATEGORITË PËR FITUESË

Përkatesisht në skemën e ndihmës ekonomike mund të përfshihen familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; jetimët të cilët nuk janë në institucione; si dhe prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë. Gjithashtu, pagesën e ndihmës ekonomike mund ta marrin edhe viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre; viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes si dhe fëmijët e vendosur në shërbimin e kujdestarisë. "Familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore ku kanë vendbanimin", -bën me dije Shërbimi Social Shtetëror.

APLIKIMI

Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari, së bashku me bashkëshorten nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti (për fëmijët certifikata) dhe dokumente të tjera të përcaktuara në aktet nënligjore. "Administratori, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike të cilët përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Është me shumë rëndësi që informacioni të jetë i saktë, pasi në rast të

Kush mund të përfitojë pagesën e ndihmës ekonomike, ja 6 kategoritë

Formula e pikëzimit, si bëhet verifikimi nga ShSSH



Shërbimi Social Shtetëror

kundërt penalizohen familjet për deklarin të rremë", -thekson ShSSH.

VERIFIKIMI I TË DHËNAVE

Ndërkohë, lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje. Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra të lidhur me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla, si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale.

VENDIMI NGA SHSSH

"Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social dërgon vendimin final së bashku me listën e familjeve fituese me masën e përfitimit dhe familjet jopërfituese me ar-

FORMULA E PIKËZIMIT

Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik. Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale.

ANKIMIM ME SHKRIM

Familjet të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu ruajnë të drejtën e ankimit në lidhje me vendimin e marrë. Ankimimi duhet të bëhet me shkrim fillimisht pranë njësisë vendore, e cila duhet të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve kalendrike nga marrja e ankesës.

syet përkatëse kryetarit të njësisë vendore për të njoftuar të gjithë aplikantët dhe për të bërë ekzekutimin e pagesës. Për të gjitha familjet përfituese është e detyrueshme paraqitja çdo 3 (tre) muaj tek zyra e administratorit shoqëror, i cili plotëson deklaratën social-ekonomike dhe e hedh në sistem si dhe verifikon gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të

parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike", -nënvizon Shërbimi Social Shtetëror. Përfituesit duhet të kenë kujdes pasi mosparaqitja një herë në 3 muaj dhe moslejimi i verifikimit social-ekonomik në familje largon familjen nga skema e ndihmës ekonomike.

ANKIMIMI

Një mundësi e dytë iu ofrohet të skuallfikuarve. Kështu familjet, të cilat janë

KUSH MUND TË PËRFITOJË NDIHMËN EKONOMIKE:

- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
 - Jetimët, të cilët nuk janë në institucione;
 - Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
 - Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
 - Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.
 - Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë
- Nga ndihma ekonomike mund të përjashtohesh nëse:
- o Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes me përjashtim të rastit vajzë nënë;
 - o Nuk tërheq në kohë ndihmën ekonomike;
 - o Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;
 - o Fsheh informacionin / kryen deklarin të rremë dhe nuk deklarohet ndryshimet e situatës social-ekonomike;
 - o Refuzon përshirjen në kurset e formimit profesional ose ofertat e përshatshme për punë të zyrave të punës dhe nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës.

Informacioni për pranimin apo refuzimin e dhënies së ndihmës ekonomike jepet nga bashkia/njësia administrative, në përfundim të muajit për të cilin aplikimi është i vlefshëm.

DETYRIMET

Për të gjitha familjet përfituese është e detyrueshme paraqitja çdo 3 (tre) muaj tek zyra e administratorit shoqëror i cili plotëson deklaratën social-ekonomike dhe e hedh në sistem si dhe verifikon gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike", -nënvizon Shërbimi Social Shtetëror.

refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe, gjithashtu, ruajnë të drejtën e ankimit në lidhje me vendimin e marrë. Ankimimi duhet të bëhet me shkrim fillimisht pranë njësisë vendore, e cila është e detyruar të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve kalendrike nga marrja e ankesës. Pas ezaurimit të ankimit të njësisë vendore, ka të drejtë të ankimo-

je të Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe në gjykatë. Ndërkohë, për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bilok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të buxhetit vendor.

Ambasada amerikane: Kujdes, universitetet duhet të jenë plotësisht të akredituara

Voltiza Duro

Që prej 1 marsit të këtij viti, studentëve shqiptarë u ka lindur e drejta e aplikimit për të përfutur nga programi veror i punësimit. Ditën e djeshme, ambasada amerikane ka bërë me dije se studentët fitues do të kenë mundësi të udhëtojnë për tre muaj në Shtetet e Bashkuara. "Programi Veror i Punësimit dhe Udhëtimit është një mundësi e shkëlqyer për studentët e universiteteve për të mësuar rreth kulturës amerikane duke jetuar në Shtetet e Bashkuara, duke punuar me kohë të pjesshme dhe duke udhëtuar përreth Shteteve të Bashkuara për tre muaj. Sigurisht, kur programi mbaron, ju duhet të ktheheni në Shqipëri që të përfundoni universitetin!", - thotë ambasada në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare në rrjetin social "Facebook".

KRITERET

Në vitet e mëparshme, nxënësit shqiptarë kanë udhëtuar në qytete të ndryshme në të gjitha Shtetet e Bashkuara, ku ata patën mundësinë të përjetonin kulturën Amerikane me anë të Programit Veror të

Punësimit. Ata nga ana tjetër ndanë kulturën dhe gjuhën e tyre me komunitetet pritëse dhe dhanë një përvojë reciprokisht të dobishme ndërkulturore në këmbim. "Për të marrë pjesë në Programin Veror të vitit 2019 të Punësimit, aplikantët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme: ata duhet të jenë studentë me kohë të plotë në një universitet të akredituar së fundmi, të cilët kanë përfunduar të paktën një semestër të vitit të parë të universitetit; duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze dhe të kenë rezultate të mira shkollore; çdo student, duhet të jetë i aftë të demonstrojë se ai/ajo do të kthehet në Shqipëri në përfundim të programit", - thotë ambasada e SHBA-ve



Ambasada e SHBA-ve në Tiranë

në Shqipëri. Ndërkohë, edhe studentët e vitit të fundit mund të aplikojnë, por ata mund të kenë më shumë vështirësi për të dhënë prova të lidhjeve të mjaftueshme me Shqipërinë. Për ata që kanë ndjekur më pak se një vit universitet, koha e studimeve mund të mos konsiderohet një investim i konsiderueshëm në shkollim aq sa të krijojë lidhje me Shqipërinë. Ata duhet të kenë një vend pune të konfirmuar në Shtetet e Bashkuara, në kohën e intervistës. Gjithashtu, për këtë program mund të aplikojnë edhe studentët me kohë të pjesshme, me korrespondencë, ashtu si edhe ata që ndjekin shkolla profesionale, ata që mësojnë në distancë dhe shkolla të mesme për të rritur nuk kualifikohen për Programin Veror të Punësimit. "Ne nuk mund të miratojmë vizat e Programin Veror të Punësimit për studentët që nuk marrin pjesë në një institucion plotësisht i akredituar. Studentët që ndjekin programet e akredituara brenda institucioneve të paakredituar nuk do të pranohen. Ambasada nuk

lim aq sa të krijojë lidhje me Shqipërinë. Ata duhet të kenë një vend pune të konfirmuar në Shtetet e Bashkuara, në kohën e intervistës. Gjithashtu, për këtë program mund të aplikojnë edhe studentët me kohë të pjesshme, me korrespondencë, ashtu si edhe ata që ndjekin shkolla profesionale, ata që mësojnë në distancë dhe shkolla të mesme për të rritur nuk kualifikohen për Programin Veror të Punësimit. "Ne nuk mund të miratojmë vizat e Programin Veror të Punësimit për studentët që nuk marrin pjesë në një institucion plotësisht i akredituar. Studentët që ndjekin programet e akredituara brenda institucioneve të paakredituar nuk do të pranohen. Ambasada nuk

AFATI I QËNDRIMIT

"Programi Veror i Punësimit dhe Udhëtimit është një mundësi për studentët duke punuar me kohë të pjesshme dhe duke udhëtuar përreth Shteteve të Bashkuara për tre muaj. Sigurisht, kur programi mbaron, ju duhet të ktheheni në Shqipëri që të përfundoni universitetin!", - thotë ambasada.

mund të miratojë çdo aplikim që nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme", - bën me dije ambasada amerikane.

Kontabilistë! Sigurimi i jetës është

bilanci më i sigurt i jetës suaj!



Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të papriturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



Sigurim për Jetën




Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al



PROSEED: Announcement

Social Initiatives – Call for Expressions of Interest and submission of Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Social Initiatives seeks in partnership with local CSOs to foster the inclusion perspectives of marginalized youth in employment and /or education. In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) submission of project Proposals from **19 April – 10 May 2019** at giz-albanien@giz.de. The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging up to 50,000 EURO (equivalent in ALL).

Main Steps of the Procedure:

First step: (i) Expressions of Interest
All interested CSO at least with 2 years of experience implementing projects in the field of youth empowerment shall write to giz-albanien@giz.de with the following text:

"We herewith declare our interest to participate in the 3rd Call for Proposals, organized by the GIZ ProSEED programme under the Social Initiatives Component. Please send us the respective Application Package".

Second Step: (ii) Submission of Application.
Upon receipt of the application package the CSO should consult the Application Guidelines to prepare their project proposals for all related eligibility criteria. The Application Guidelines (a separate document) can be downloaded from the ProSEED Facebook page. Deadline for the submission of application is **10 of May 2019**.
The application package must be submitted electronically in English at giz-albanien@giz.de. Applications submitted in hardcopies shall not be taken into consideration.
(Applying CSOs must take care to submit the budget in excel as a separate template and not merge it with the project description).

Third Step: (iii) Assessment and Evaluation of Proposals
Upon submission of the proposals by the CSOs the assessment and evaluation procedure shall be implemented as described in the Application Guidelines. For more information and the timeline of procedure please consult the Application Guidelines of this 3rd Call for Proposals.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to express your interest and receive the application package.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **19 April – 10 May 2019**.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.




MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KËRKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID





NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

Ne kushtet FOB:
Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K

Në pikat e lëvrim:
Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

 - 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (peshat specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
 - Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
 - 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).
- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula (Ke⁰).**
- Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Në pikat e levrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçove, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Informacion mbi dokumentet e ankandit:**
Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo X

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos / Zyra në Tiranë Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë
T +3553813662 F +35534704415 W www.albpetrol.al

Papa Françesku, më 7 maj viziton për herë të parë Shkupin

Ardhja e Atit të Shenjtë pas 25 vitesh, Zoran Zaev: Moment i rëndësishëm për vendin

Ardhja e Papa Françeskut në Maqedoni më 7 maj vlerësohet si mbështetje për vendin në drejtim të zhvillimit në plan kombëtar dhe ndërkombëtar, nga një prej liderëve fetarë më me ndikim në botë. Kjo lidhet me marrëdhëniet e afërta që Vatikanin ka tradicionalisht me Maqedoninë, në çastin kur shënohen 25 vite nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike bilaterale, vlerësojnë përfaqësuesit e shtetit. Ati i Shenjtë në Shkup do të mbajë mesazh në sheshin e qytetit ku pritet të marrin pjesë mijëra besimtarë, do të takohet me kreun e shtetit, por edhe me udhëheqësit e bashkësive fetare në vend. Gjatë qëndrimit 10 orësh në Shkup, Papa Françesku do të ketë takime me krerët më të lartë shtetërorë, me udhëheqësit e bashkësive fetare dhe do t'u drejtohet qytetarëve në sheshin e Shkupit. Vendimi për ta vizituar Maqedoninë, Kryeministri Zaev e vlerëson si afirmim për vendin. "Vjen në moment shumë të rëndësishëm për vendin tonë, kur vendi ynë është vërtetë mik me të gjithë, kur treguam hapa të guximshëm. Në një mënyrë prek edhe porositë fetare të cilat edhe Ati i Shenjtë i promovon në botë".

Nënë Terezës. "Për këtë arsye ju bëj thirrje, lutem për ju, që kjo vizitë apostujsh të jetë dhuratë e dashurisë, ngjarje historike, dhe jo vetëm sensacion ose manifestim". Vizita e Papa Françeskut në Maqedoni,



Papa Françesku

Nënë Terezës. "Për këtë arsye ju bëj thirrje, lutem për ju, që kjo vizitë apostujsh të jetë dhuratë e dashurisë, ngjarje historike, dhe jo vetëm sensacion ose manifestim". Vizita e Papa Françeskut në Maqedoni,

për komunitetin katolik, por edhe për tërë vendin është e rëndësishme historike, deklaroi Anton Sereci, zëvendës kryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare. "A është historike? Është më shumë se historike."

ZORAN ZAEV:

"Vjen në moment shumë të rëndësishëm për vendin tonë, kur vendi ynë është vërtetë mik me të gjithë, kur treguam hapa të guximshëm. Në një mënyrë prek edhe porositë fetare, të cilat edhe Ati i Shenjtë i promovon në botë".

Për herë të parë Ati i Shenjtë, Papa vjen në një vend biblik, në Maqedoni, për të cilën e dimë se përmendet disa herë edhe në Bibël, por edhe për ngritjen e moralit dhe besimit të njerëzve në marrëdhëniet e mira fqinjësore, për paqen dhe për bashkëjetesën". Interesi për vizitën e Papës është i madh edhe tek mediat. Për këtë ngjarje deri më tani janë akredituar rreth 400 gazetarë, 200 prej të cilëve nga vendi. Për shkak të pranisë së Papës, niveli i sigurisë në Shkup do të jetë në nivelin më të lartë.

Kryeministri akuzon Mogherinin: I ka bërë shumë dëme BE-së dhe Kosovës

Samiti i Berlinit, Haradinaj: Nuk do e heqim asnjëherë taksën

Takimi në 29 prill, të pranishëm Macron e Merkel

Ramush Haradinaj, kryeministri i Kosovës, është shprehur se taksa ndaj produkteve serbe nuk do të hiqet as në samitin e Berlinit e as në ndonjë samit tjetër. Një deklaratë të tillë, kryeministri Haradinaj e ka bërë në emisionin Pressing, ku ka komentuar edhe Samitin në Berlin, në të cilin pritet pjesëmarrja e Kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez, Emmanuel Macron. "5 deri në 7 është pjesa formale, ndërsa është një pjesë tjetër që quhet vazhdim, e që temë është Kosova. Aty nuk janë vetëm palët nga Kosova, por edhe nga regjioni. Gjatë gjithë kohës do të jenë edhe Merkel edhe Macron", është shprehur kryeministri. Haradinaj ka folur edhe për rolin e përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini, me të cilin ka pasur përplasje e mosmarrëveshje. "Mogherini i ka bërë shumë dëme BE-së dhe Ballkanit. Gati na ka kthyer në të kaluarën. Në vend që të ketë fokusin te tema e njohjes së Kosovës, ajo e ktheu te tema e territoreve. Nuk besoj që duhet të presim zgjidhje nga z. Mogherini", është shprehur ai. Ndërkaq ditë më parë, kryeministri i Kosovës është shprehur se nuk tërhiqet nga qëndrimet e mbajtura prej tij për përfaqësuesen e BE-së, Frederica Mogherini, kur tha se ajo ka shkaktuar trauma në rajon dhe ka devijuar dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Kur kanë mbetur edhe pak ditë nga Samiti i Berlinit më 29 prill, shefi i qeverisë tha se do të mbajë gjithmonë këtë qëndrim kur në tryezë dhe objekt bisede është interesi kombëtar. "Takimi i bie që është nga Kancelaria Merkel. Për ne nuk ka vërejtje se kush merr pjesë në këtë

takim. Nuk ka ndonjë ndryshim në qëndrimet tona sa i përket saj që i kam thënë Mogherinit. Kam dashur t'i them Mogherinit dhe në të shkuarën dhe do ia them sa herë të jetë nevoja për të mbrojtur të drejtën e vendit tim. Diskutimi për kufij, territore ka qenë gabim, kjo gjë ka destabilizuar rajonin dhe është mirë që është tejkaluar. Nuk është mirë që ta mbajmë gjallë këtë temë sepse vetëm e destabilizon rajonin", theksoi ai.



Kryeministri Ramush Haradinaj

Kryeministri tha se retorika e tij nuk është personale me Mogherinin, por kritikata bazohen tek

tema, e cila sipas tij ka qenë e gabuar. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se cili është pozicioni i Macron në diskutimin për shkëmbimin e territoreve në takimin që do të bëhet në 29 prill në Berlin. Në Francë ka shumë simpati për një demarkacion të ri. Ish-ministri i Jashtëm, Bernard Kouchner deklaroi në shtatorin e kaluar se shkëmbimi i territoreve është "një zgjidhje e mirë". "Komiteti ndërkombëtar nuk ka të drejtë që të ndë-

RAMUSH HARADINAJ:

"Mogherini i ka bërë shumë dëme BE-së dhe Ballkanit. Gati na ka kthyer në të kaluarën. Në vend që të ketë fokusin te tema e njohjes së Kosovës, ajo e ktheu te tema e territoreve. Nuk besoj që duhet të presim zgjidhje nga z. Mogherini", është shprehur kryeministri.

Këshilltari i kryeministrit kosovar ndalohet nga policia serbe

Partia Liberale Serbe e Kosovës, njofton se të enjten në vendkalimin kufitar mes Kosovës dhe Serbisë në Dheun e Bardhë, është ndaluar nga ana e policisë serbe, Sërgjan Jovanović, anëtar i Partisë Liberale Serbe, njëherësh këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Kryetari i Partisë Liberale Serbe, Slobodan Petrović ka thënë se ky nuk është rasti i parë që zyrtarët e kësaj partie ndalohen në vendkalimet kufitare mes Kosovës dhe

Serbisë. "Jovanović është ende në vendkalim. Pjesëtarët e Ministrisë së Brendshme të Serbisë i kanë thënë atij se kishin një urdhër për ta mbajtur atë deri në ardhjen e anëtarëve të BIA-s (Agjencia për Siguri dhe Informacion të Serbisë) për ta intervistuar", ka thënë Petrović duke kërkuar reagimin e menjëhershëm për këtë rast të autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare. Autoritetet kosovare kanë reaguar menjëherë përmes rrjeteve sociale. Kryeministri i Kosovës, Ramush Ha-

radinaj tha se ky rast dëshmon qartë se metodat e frikësimit që përdoren nga autoritetet serbe, janë një shenjë agresioni, ndaj qytetarëve të Kosovës. Akti i ndaljes së Sërgjan Jovanovićit nga ana e autoriteteve serbe, sipas kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe pasigurisë tek serbët e Kosovës. Më parë, në disa raste, në vendkalimet kufitare Kosovë-Serbi, autoritetet serbe i kanë intervistuar për orë të tëra pjesëtarët serbë të Forcës së Sigurisë

së Kosovës. Që nga dhjetori i vitit të kaluar, në Merdare janë ndaluar dhe janë intervistuar Slobodan Petrović, deputet i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i Partisë së Pavarur Liberale, si dhe bashkëpunëtorët e tij, Boban Stanković, zëvendësministër i Kulturës në Qeverinë e Kosovës dhe Nebojsa Jakovljević, këshilltari në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në qeverinë e Kosovës. Intervistimet kanë zgjatur për orë të tëra.


rhyje me Thaçit dhe Vuçiç" - tha Kouchner, që konsiderohet si një njeri i besuar i liderit të Kosovës. Mes 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor është më e mundshme që Serbia dhe Mali i Zi të arrin një hyrjen në BE. Vitin e kaluar Komisioni Europian premtori të përfshinte të dy vendet brenda vitit 2025. Këtë vit Komisioni Europian nuk dëshiron të publikojë relacionet e saj të progres-raportit për Ballkanin Perëndimor gjë që do ta bëjë pas zgjedhjeve europarlamentare. Me këtë rast, autoritetet në Bruksel do të evitoni edhe diskutimet e bezdisshme për zgjerimin me vende të Ballkanit që i afrohen Unionit.

Balerina e njohur shqiptare, Klaudia Pepa, prej kohësh tashmë ka vazhduar karrierën e saj në Itali ku dhe është mjaft e njohur. Në foton e fundit të publikuar në 'Instagram', balerina shfaqet shumë seksi e veshur me bikini teksa qëndron mbi një varkë, por disa fansa kanë vënë re një detaj dhe nuk mund të mos ia komentonin asaj. Përveç se po shijon momentin me sytë e mbyllur, Klaudia mban dhe një çantë të vogël. Është pikërisht kjo çantë që ka bërë që fansat ti shkruajnë bukuroshes "Pse duhej ajo çantë me bikini?" Më tej, dikush tjetër i shkruan: "Kjo çanta që ke varur ti është njësoj si të shkosh me taka në plazh me rërë!" Klaudia duket se i ka marrë qetësisht këto reagime duke mos u kthyer akoma atyre ndonjë përgjigje. Kujtojmë se Pepa është pëlqyer shumë në videoklipin e fundit të Getoarit me koreografinë e saj.



Klaudia Pepa më seksi se kurrë, por fansat kapin detajin e çuditshëm në foto

Aketa Vejsiu mbetet një nga moderatoret më të dashura për publikun e ndër më të ndjekurat me emisionet e saj apo në rrjete sociale. Në fundmi Aketa ka nisur pushimet disa ditore dhe fotot nga vendi mahnitës i ka publikuar në 'Instagram'. Në një prej fotove moderatorja shfaqet e veshur me vetëm një këmishë e kapele dhe ka marrë komplimente të shumta. Mirëpo mes komenteve dallon një komentuese, e cila i shkruan: "S'e kuptoj pse e zgjat veten me photo-shop kot, sepse të kam parë dhe live dhe s'je ndonjë dy metroshe, as e shkurtër nuk je, por që dhe kaq sa i bën fotot jo e jo". "Do t'i shkurtroj herës tjetër! Do dal pa këmbë fare në foto. Në jetë s'kam ç'ti bëj, i kam 172 cm nga natyra, dhe 182 me taka."- ia ka kthyer moderatorja. Por, Alketës i ka dalë në mbrojtje Oriola Marashi, e cila ka shkruar se të dyja i bashkon i njëjti hall, pasi fansat i akuzojnë për fotoshop për shkak të këmbëve të gjata. "Të njëjtin hall kemi ne vajzat me shalët e gjata."- shkroi Oriola.



Oriola i del në mbrojtje Alketës: Kemi të njëjtin hall

Reflektuan nga Ledri? Reperja e njohur i kërkon publikisht falje Taynës

Prej disa kohësh kemi parë deklarata nga më të ndryshmet të repereve të njohura shqiptare si Tayna, Melinda, Rina apo edhe Fifi. Reperet e reja s'kanë reshtur së ngacmuari njëra-tjetren në deklarata të ndryshme publike apo edhe nëpër këngë. Por siç duket reperja e njohur Melinda Ademi ka reflektuar dhe nëpërmjet një postimi në 'Instastory', këngëtarja Melinda i ka habitur të gjithë teksa ka kërkuar falje publikisht Taynës për gjithë fjalët që ka thënë për të në tekstet e këngëve të saj. "I kërkoj falje artistes Tayna për ofendimet në freestyle-in e fundit. Për shkak të drejtimit që ka marrë rep-i i femrave mendoj se duhet të ndryshojmë drejtimin dhe mos të nxisim urrejtje të gjeneratave të reja", shkruan Melinda në Insta Story. Kjo ndjesë erdhi pak kohë pasi Ledri Vula gjatë një interviste tha se nuk po i pëlqen që femrat po shahen nëpër këngë dhe se ato mund të bëjnë rep të mirë pa ofenduar.



Për ata të dy kjo periudhë ka qenë tejet e veçantë. Ajo ka marrë një nur të ëmbël nga shtatzënia. Almeda Abazi tashmë është më pranë se kurrë lindjes. Ish-miss shqiptar ka ndarë me ne shumë momente të bukura gjatë shtatzënisë, që së bashku me aktorin Tolgahan Sayisman po e presin me kaq gëzim. Ata kanë vendosur që bebin ta quajnë Efehan, një emër i veçantë sipas traditave. Diten e djeshme bukuroshja ka ndarë disa pamje të dhomës së bebushit të saj. Nga videoja arrijmë të dallojmë se mbizotëron ngjyra e bardhë dhe blu. Krevati është madhështor brenda të cilit qëndron një elefant. Ky simbol i elefantit mund të jetë edhe një paralelizëm me emrin e djalit. Duket pra se gjërat janë bërë më së shumti gati me Almedën që nuk po i mban vendi nga gëzimi.



Almeda Abazi na ngrohu zemrën me foto nga dhoma e të birit, ja çfarë dekori ka

Rrëfëhet këngëtarja: Jeta ime mes Londrës dhe Shqipërisë, ja kur del albumi i ri

Valbona Halili:



Nuk heq kurrë dorë nga live, këngët komerciale vdesin shpejt

"Kostumin popullor ma pëlqejnë gjithandej"

Ajo është një nga këngëtares më të dashura për publikun. Shumë prej këngëve të saj janë kthyer në hite dhe zënë një pjesë të mirë të gazeimeve familjare, si dhe dasmave, sidomos në zonën e Shqipërisë së mesme. E kemi fjalën për Valbona Halilin. Artistja vjen në një intervistë ndryshe për "Gazeta shqiptare" për të na zbuluar copëza detajesh nga jeta e saj në Londër; nga mungesa që i krijon në shpirt largësia me vendin e saj, projektet e fundit si dhe të ishehta të tjera që nuk i dinin për të. Halili ka ardhur me plot energji të "Zemrën ma ke borxh", që pritej prej kohësh nga fansat. Përtej shkëlqimit në skenë ne njohim një Valbonë të thjeshtë, miqësore dhe që rrezaton mirësi. Fundja madhështia qëndron te ata artist që ngelen të tillë edhe kur nuk janë në skenë, po që dinë të jenë të veçantë sikur janë nëpër performanca.

Në klipin tuaj më të fundit, cilët ishin bashkëpunëtorët dhe si u prit?

"Zemrën ma ke borxh" është klipi im i ri me muzikë nga Gramoz Kozeli dhe me tekst të Fifit. Është pritur shumë mirë, akoma më shumë se sa e prisja dhe jam shumë e kënaqur.

Çfarë është muzika për ju?

Muzika më jep frymë për të jetuar, është pasioni im. E kam shumë të vështirë të jetoj pa muzikë.

E ndjeni veten me fat?

Po e ndjej dhe e falënderoj zotin për gjithçka më ka dhënë.

Valbona e përshkruar me tri fjalë?

Energjike, e zgjuar dhe e suksesshme.

Ku do ju shohim së shpejti, a keni ndonjë projekt të afërt?

Projekti im më i afërt është album i radhës në bashkëpunim me mjeshtër të madh Edmond Zhulali.

Planet e kësaj vere, cilat do të jenë?

Vera është shumë e ngjeshur për ne këngëtarët, jam e zënë me koncerte e dasma dhe aktivitete të ndryshme.

Dëshira juaj më e madhe?

Sikur të më binte telebingo. (qesh) Motoja që ju bashkëshoqëron gjithmonë? Dua të shoh dhe të dëgjoj mirë për të gjithë.

Jetoni mes Londrës dhe Shqipërisë, ku ndiheni më mirë?

Unë ndihem shumë mirë në Shqipëri, sepse kam njerëzit e mi të afërt, por edhe në Londër jam shumë mirë.

Nuk ke hequr dorë kurrë prej kostumit popullor.



pajtonit', etj..

Si e shihni këngën shqipe sot?

Ah, kënga shqipe sot! Kanë hyrë shumë rryma. Por, kënga popullore dhe muzika e lehtë do të ngelen në jetën e shqiptarëve, brez pas brezi. Nuk ka më mirë se të jemi origjinalë. Gjithçka që është fals, del e shihet, pastaj vdes shpejt. Kemi këngë të bukura dhe e kemi një kulturë të lashtë. Është më mirë të investojmë më shumë në artin e mirëfilltë,

sesa në kulturën e huaj. Ne duhet t'i duam dhe t'i respektojmë të tjerët, por tonën duhet ta duam pak më shumë.

Çfarë do të thotë për ju të këndosh live?

Muzika live është emocion më vetë dhe nuk mund të krahasohet me asgjë. E adhuroj të kënduarin live, jo vetëm sepse në këtë mënyrë këngëtarja/ja e vërteton vlerat e veta vokalistike, por edhe sepse ndjehet shumë mirë.



Pse?

Veshjen popullore, kostumin e bukur të viseve të mia, ma pëlqejnë gjithandej, ma preferojnë, madje, dhe ma kërkojnë. Veçanërisht në Angli, të gjithë më shtrojnë kërkesën për kostumin popullor. Tani vlerësohet dhe në Shqipëri. Më vjen mirë që është rikthyer dëshira për të

respektuar bukurinë e kostumit popullor shqiptar.

Sa të mërziqshme janë udhëtimet për ju?


Janë të mërziqshme ngaqë janë shumë. Udhëtoj vazhdimisht. Por, unë jam shumë energjike, dhe jo gjithmonë më lodhin. Secili është i veçantë dhe gjithmonë kam se çfarë të kujtoj jo vetëm

nga koncertet, por edhe nga udhëtimet.

Nga repertori juaj muzikor, cilën këngë do të veçonit?

Mua nëse nuk më pëlqen një këngë, nuk e bëj pjesë të repertorit tim. Të gjitha këngët e mia më pëlqejnë, por ka edhe disa që do t'i veçoja si: "Tata", "Kur ti hyp

EKSPOZITA



ALEKSANDËR MOISIU

Nga kurora e mbretit të skenës te maska e vdekjes

Aleksandër Moisiu, njeriu dhe artisti", është ky titulli i ekspozitës që prezanton foto dhe dokumente të panjohura më parë mbledhur në arkivat austriake nga studiuesi Pjetër Logoreci gjatë një periudhe kërkimore 7-vjeçare. Kjo ekspozitë e organizuar nga Fondacioni "Moisiu" dhe COD u hap mbrëmë më 25 prill, ora 18:40.

44 foto të printuara në kanaçë tregojnë disa nga momentet më të rëndësishme të jetës së Moisiut si: fëmijëria, familja, dokumentet e rëndësishëm të jetës së aktorit, si dhe pamje nga rolet e tij në film e teatër. Janë bërë publike për herë të parë foto e imazhe të objekteve personale të aktorit si: stampa e dorës, flokët origjinalë, maska e vdekjes, spalletat e ushtarakut, kurora e aktorit më të mirë të Evropës, si dhe disa foto nga ceremonia mortore e Aleksandër Moisiut në Vjenë. Ekspozita sjell foto me objektet personale të aktorit, pronë e Muzeut Kombëtar të Teatrit Austriak, shumë nga të cilët së bashku me dokumente shkresorë apo korrespondencën e tij personale, janë dhuruar në vitin 1958 nga bashkëshortja e tij Johanna Terwin. Në vitin 1971, këtë koleksion iu shtua dhe trashëgimia dokumentare që kishte mbledhur për Aleksandrin, adhuruesja e tij, Maria Dobrozensky. Përveç këtyre objekteve, në Fondin Moisiu, ka dhe shumë vepra të tjera, si të shkruara, ashtu dhe nga arti pamor të cilat mungojnë këtu, sepse u përkasin koleksioneve private.

Përveçse i jashtëzakonshëm profesionalisht, ai ishte i jashtëzakonshëm dhe si njeri. Ai nuk shmangu apo refuzoi asnjëherë ftesat për takime që i dërgoi komuniteti shqiptar. Shumë herë ai i kishte shfaqur dëshirën për një vizitë në Shqipëri si dhe për të patur shtetësinë shqiptare. Në një njoftim që konsullata shqiptare në Vjenë i dërgon MP Jashme në Tiranë shkruhet: "Më 7 nëntor 1933 u paraqit në konsullatën shqiptare në Vjenë, artisti i famshëm Aleksandër Moisiu, i cili bëri kërkesën për marrjen e shtetësisë shqiptare për vete dhe bashkëshorten Johanna Terwin Moisiu. Ky refuzoi gjithë shtetësitë e tjera dhe dëshiron të pranohet vetëm si shtetas shqiptar, siç ka qenë dhe familja e tij e dalë me kohë prej Kavaje". Gjigandë të artit botëror si Pirandello, Chaplin,



MJESHTRI SHQIPTAR

"MARKA" PRELJOCAJ, KOREOGRAFI ANËTAR I AKADEMISË FRANCEZE

Koreografi francez me origjinë shqiptare Angjelin Preljocaj, zgjidhet anëtar i Akademisë Franceze të Arteve të Bukura! Urime akademiku Preljocaj! Ka qenë njoftimi që ka dhënë dje Akademia e Shkencave të Shqipërisë, duke njoftuar kështu një tjetër pikë të rëndësishme të karrierës së shqiptarit që ka shënuar suksese të jashtëzakonshme në skenën franceze e më gjerë. Shpesh në baletet e realizuara prej tij janë bërë pjesë ose kanë qenë si pikë frymëzimi edhe ritet e zakonit shqiptar, si dasma, një prej veprave të tij që u frymëzua nga dasma shqiptare e së motrës. "Unë jam tronditur kur kam dëgjuar për herë të parë kompozimin "Dasma" nga Stravinski. Kjo tronditje ndodhi, sepse kisha parë martesat në Francë dhe i konceptoja si diçka të gëzueshme, plot hare, por kur dëgjova muzikën e Stravinskut, më ndodhi një tronditje, dhimbje,

që më sillte ndërmend dhe ato kujtime të fëmijërisë sime, lidhur me zhvillimin e dasmave shqiptare", që shprehur ai në Tiranë katër vite më parë. Atëherë në moshën 58-vjeçare, Angjelin Preljocaj i kishte ende të freskëta kujtimet e fëmijërisë së hershme kur e motra marotohej në Francë me një shqiptar ndërsa ai shihte një ceremoni të "frikshme" dasme, të cilën nuk ka ngurruar ta përkthente në gjuhë koreografike, në baletin që u vu në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit nën titullin "Dasma".

Angjelin Preljocaj do të jetë pjesë e Akademisë Franceze të Arteve të Bukura, në seksionin e koreografisë, në të cilin janë pjesë edhe tre koreografe të tjerë. Gjatë ditëve në vazhdim këto do t'i dorëzohen për miratim edhe Presidentit të Francës, i cili është mbrojtës i Akademisë. Seksioni i Koreografisë u formua në 9 tetor të vitit 2018. Akademia e Arteve të Bukura është një nga pesë aka-

demitë që përbëjnë Institutin e Francës. Me 63 anëtarë në 9 seksione artistike, ajo përipiqet të promovojë dhe inkurajojë krijimin artistik në të gjitha shprehjet e saj dhe të mbrojë trashëgiminë kulturore franceze.

Preljocaj i lindur në Francë nga prindër shqiptarë, i nisi studimet me baletin klasik, përpara se të merrej me baletin modern dhe të arrinte të trondiste me krijimtartinë e tij skenat botërore. Sot Preljocaj numëron 50 pjesë koreografike të baletit klasik, nga solot, deri tek format më të mëdha. Në botën e baletit, Angjelin Preljocaj është një prej personazheve më të padiskutueshëm në famën dhe talentin e tij. Punëtor i palodhur, ai, gjithashtu, propozon një koncept të ri të baletit, një përzjerje rrymash artistike. ai sot drejton trupën e tij të baletit në Aix-en-Provence: Baleti Preljocaj.

njerëzit me sytë e tij, me zërin e tij".

Aktori lindi më 2 prill të vitit 1879 në Trieste dhe vdiq 23 mars 1935 në Vjenë.

Për kritiken italiane, Alessandro është një triestin i lindur (pa përmendur prejardhjen e prindërve emigrante), përfaqësues i denje e shkollës italiane të aktrimit. Në të vërtetë ai kaloi në Trieste një periudhë të vështirë të fëmijërisë së tij, me shume probleme familjare dhe ekonomike për të cilat familja e tij u detyrua të largohet për një jetë më të mirë, drejt Austriës.

Për teatrin austriak, Moisiu u "zbulua dhe u formua" në Vjenë, edhe pse aty u përball me probleme të mëdha të integritetit, u nënvleftësua dhe ju mbylleen dyert e skenës si i paafte dhe i pataleutuar në fushën e kantos e të teatrit. Teatri gjerman i Pragës ishte vendi ku Moisiu gjeti përkrahje dhe ju hapen mundësitë për të filluar karrierën e tij si aktor. Në themel të karrierës së tij qëndron këmbëngulja e superaktorit austriak Kainz, i cili zbuloi tek djaloshi Moisi të ardhmen e teatrit modern dhe e drejtë atë drejt Pragës ku punonin miqtë e tij.


Fillimi i tij në teatrin e Pragës me eksperiencat që krijoj, ishte shkolla e vërtetë për artin skenik të Moisiut. Por talenti i pakufi i Moisiut me sukseset e njëpasnjëshme kërkonte një ambient me të gjerë, e të përmasave botërore siç ishte skena e teatrit në Berlin. Mbas dy vjetësh e gjysmë debutimi në Pragë, ku mundësitë ishin të kufizuara, më 17-të dhjetor 1903 emri i Aleksandër Moisiut shfaqet në afisheet e teatrit të Reinhardt - it në Berlin me rolin e aktorit në dramën me temë shoqërore "Na dne" të Maksim Gorkit (të shkruar në 1902).

DEBATI PËR REGJIMIN

Agron Tufa nxjerr dokumentet: Kundërshtari im ka prejardhje kufomash



Së fundmi Agron Tufa drejtues i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojeve të Komunizmit ka pasur përplasje publike me deputetin Spartak Braho dhe ish-kuadrimin e kampit të të burgosurve politikë nr.311 Qafë-Bari Pukë, Edmond Caja. Debatet kanë të bëjnë me rolet e këtyre dy personazheve në të kaluarën, pozicionet që kanë mbajtur gjatë komunizmit dhe së fundmi, Tufa ka nisur edhe procese gjyqësore për shkak të kërcënimeve që ka marrë pasi ka publikuar dëshmi e dokumente mbi këta dy emra. Në krah të Tufës në këtë debat kanë qenë edhe emra të tjerë ish-të përndjekur e ish-të burgosur që gjatë komunizmit i kanë njohur në kampe, burgje e përmes vendimesh këta emra. Gjatë ditës së djeshme, Tufa ka publikuar tri dokumente edhe për një tjetër emër, kundërshtar i tij. Tufa ka marrë përsipër të publikojë dokumentet që disponon për ata që kanë pasur poste në komunizëm dhe kanë ende në demokraci, e sidomos për ata që ende sulmojnë ish të përndjekurit. Kujtojmë se në Shqipëri pas rënies së regjimit nuk pati gjyqe që dënuan krimet e komunizmit.

"Lejfenisti veshëcurrekë Shaqir Bejto Faslja, nga bërsitë e kalbura, nuk del raki e mirë"



Nga Agron Tufa

Kundërshtari im qelbet erë. Se ka prejardhje kërmash. Kufomash. Dhe spiunllëqesh: shpifësh, sajeshash. Kur u bie kresë me dokument, ndodh reaksioni i pritshëm kimik: çlirojnë erë kërmash. Si Shaqir Bejto Faslja. Nuk është as një e dhjeta e bëmave të babait, të përlyer e zhyer me gjakun e shkodoranëve dhe malësorëve të Kelmendit e krejt Malësisë së Madhe. I biri, Shaqo, ende pretendon se paska gëzuar respekt. Në realitet gëzon urretjen e krejt popullit të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe. I biri, Shaqo, ende pretendon se paska gëzuar respekt. Në realitet gëzon urretjen e krejt popullit të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe. I biri, Shaqo, ende pretendon se paska gëzuar respekt. Në realitet gëzon urretjen e krejt popullit të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe. I biri, Shaqo, ende pretendon se paska gëzuar respekt. Në realitet gëzon urretjen e krejt popullit të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.



laratate? Notat diplomatike? Zero! Gjithsesi e pranon Shaqa se shkrimi im është botuar (anipse në revistë "të qepur me tel"). Po Shaqa i vuri tutiusin ambasadës dhe u struk në benevrekë! Unë isha tek pullë, një djalosh që kërkjoja një mundësi dhe arrita të botoj nga "Novoje vremja" (me pseudonim "Elez Isufi") deri tek një revistë studentësh (ani pse e kapur me tel).

Tani ta presim shkurt: nga bërsitë e kalbura, nuk del raki e mirë. Kështu dhe Shaqir Bejto Faslja, vazhdoi rrugën e zombifikimit komunist, syri e veshi i Partisë, denonciator e spiun, për çka dëshmojnë dhe spiunimet e tij në Dëgën e Punëve të Brendshme të Shkodrës. T'ia nisim nga ky zell lejfenisti prej vigjilenti që i raporton kryekriminelit torturues Shyqyri Çokut (në DPB të Shkodrës). Të tjerat, avash-avash.

serbë dhe rusë! Dhe unë qenka trembur(!) O pika në b...! Dhe kush e thotë? Ai që i vuri tutiusin ambasadës sonë dhe u fsheh në senduk. Le t'i lëmë lloqet se paskam shkuar keq me ish- bashkëstudentët e mi e sjellje të tjera jo të partishme. Kë ka si jallan shahit? Ia vë gishtin një të vdekuri, Jorgo

Bllacit, bash atij që ishte relatori im i mbrojtjes së diplomës në Institutin e Letërsisë "Gorki" mbi krijimtarinë dhe përkthimin e poetit nobelist rus Josif Brodskij. Merr dëshmitar Jorgon, që rrinim bashkë, pinim e diskutonim. Shaqo e di se Jorgi i ndjerë, nuk ngrihet prej andej ku nuk kthehen, por

prapë nuk e lë të qetë në prehen e përjetshme. Ku i ra infarkt, për ditë me radhë Jorgo mua më pati te kryet dhe asnjë nga ambasada e Shaqës. Krenohet Shaqo ibriku se paska dhënë një a dy intervista. Ia kanë shkepur me zor, në gazeta të papërfillshme. Po ku qëndronte detyra e ambasadorit? Ku i ka dek-

ARTAN FUGA: Mbi fashistin, fshatarin dhe spiunin rus, mikun dhe kolegun tim të dashur Agron Tufa!

Nga Artan FUGA

Unë i mirëkuptoj të gjitha shqetësimet dhe angazhimet për të ruajtur të pacenuar nga askush vlerat dhe kontributin e rezistencës antifashiste gjatë Luftës së Dytë botërore në Shqipëri, për respektin për këdo që ka marrë pjesë në të, komunistë, nacionalistë, demokratë, si edhe për të gjitha kontributet, luftëtarë, dëshmorë, viktima, të deportuar në kampe, popullsi e martirizuar, etj, familje dëshmorësh. Duke pasur nja pesë a gjashtë dëshmorë e të martirizuar në familje nga bashkëpunëtorët e fashizmit dhe larot e tradhtarëve më kujtohet gjysha ja që edhe në vitet 60, më kujtohet si turbull, që lëvizte nëpër shtëpi si një hije e mëzitur, e pezmatuar, e harruar në vetminë e vet të pashërueshme nga dëmet e Luftës, nga tradhtarët

që si qenër i kishin kafshuar shpirtin, duke tymosur duhan nga mëngjesi në darkë, folur me vete, veshur në të zi dhe qarë e qarë me afshe zemre. Vuajtur nga të gjitha anët ky popull, paralufte, gjatëlufte dhe pasluftë! E kishte goditur rëndë lufta gjyshen time të mjerë e të mirë si gjyshet e gjithkujt. Nuk ja harroj gjatë ditës kur kush ka qenë për rezistencën, kush ka qenë neutral, kush ka qenë tradhtar! Kur të na bëhet mbarë edhe unë dëshiroj t'i them mikut tim Agron Tufa çfarë mendoj për ndonjë botim, i të cilit ai nuk është autor. Sikur bisedojmë ngahera për libra të tjerë! Por, kur dëgjoj se ai qenkësh fashisti i fundit në Shqipëri, nuk e mbajdot të qeshurën: hahahahahahaha! Shqipëria nuk qenka çliruar akoma!!! Paska mbetur ushtari i fundit Agron Tufa! Goni është



fashist po aq sa unë nuk jam biri i dy partizanëve në Luftën Çlirimtare, kujtimin e të cilëve në atë periudhë e kam të shenjtë në traditat familjare! Goni na qenka edhe fshatar! A thua se është sharje për-buzëse të vish nga zona dhe krahi-na plot tradita nga çdo cep i vendit! Sa qejf po të isha edhe unë fshatar si Gon Tufa! Me kulturën

perëndimore që ai ka marrë në universitetet ruse, paradoksis i madh, por i vërtetë, ai më ka habitur me botëkuptimin e tij postmodern që më ka lënë mbresa të forta dhe admirim edhe mua që prej shtatë a kusur brezash kam tradita familjare qytetase në qytete mijëvjeçare! Më urban në këtë rrafsh sesa unë ai! Goni qenka edhe spiun rus! Vërtet ka ca tipare si të Sorges ai! Ore mos është ai që i ka dërguar z. Putin planet e sulmit të fashistëve shqiptarë mbi Moskë që po përgatitet për 21 qershorin e këtij viti? Edhe kjo na duhet, të nisjet një fushatë makartiste si gueti shtrigash ndaj intelektualëve tani! Qetësohuni miq, shokë, zonja dhe zotërinj! Mjaft e thelluat kulturën anti-Mukje! Unë kam tezen se diktatura na krijoi idenë se ne e kishim kapërcyer Rilindjen e shekullit 19-të dhe ishim bërë unitarista si

komb, por kam nisur të kem dyshime të forta shumë. Por, ne nuk paskemi kaluar as anti-Mukjen! Nuk e di se çfarë thotë për këtë e shenja dhe e heshtura Akademii e Shkencave që po rinohet e bëhet si nuse në kujdesin e ndoca 14 deputetëve bashkëpunëtorë me forcat e regresit intelektual në vend! As Agron Tufa nuk është fashist, as çlirimtarët nuk barozohen dot me kriminelë luftë! E ka fajin folja "me qenë" që në shqip përdoret pa njohur punimet e të madhit Alfred Korzybski në semantikën e tij monumentale generale. Por për këtë, sa kohë që ende nuk po përgatitet botimi në kantier e sipër mund të drejtohem në ministrinë e jashtme sepse atje ju sqarojnë për çdo gjë! Jam shkrirë gazit këto ditë, sepse nuk kisha mundësi të qaja!

Opinion i Ditës

Merkel, të qëndrojnë apo të shkojnë?

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... në zgjedhjet lokale vjeshtën e kaluar në Bavari dhe Hessen, në kulmin e tensionit të krijuar brenda tij, Kancelarja Merkel u tërhoq, siç di ajo, nga rikandidimi si Kryetare e CDU-së. Gjithashtu, ajo njoftoi se nuk do të kandidojë më si Kancelare në vitin 2021.

Ky veprim i mençur politik ndihmoi shumë për shtensionimin e situatës brenda kampit të djathtë dhe me partnerët e SPD-së. Ndërkohë, Merkel vijon të drejtojë kancelarinë gjermane me një intensitet dhe efektivitet të pandryshuar, madje më të madh se më parë.

Megjithatë, janë shtuar sërish zërat dhe dyshimet lidhur me mundësinë praktike që Merkel ta çojë deri në fund, d.m.th. në vitin 2021 mandatin e katërt si Kancelare. Me këtë shpjegohen sipas tyre dhe takimet e saj intensive non-stop në çdo pikë të globit, mosmarrja pjesë në fushatën e zgjedhjeve evropiane, heqja e pikturave dhe objekteve personale nga zyra, etj.

Gjatë kësaj periudhe, qarqe dhe eksponentë politikë të CDU-së kanë kërkuar/sugjeruar që Merkel t'ia lërë vendin qysh tani pasardhëses së saj, Kryetares së CDU-së, Annegret Kamp Karrenbauer, ose Zonja AKK, siç njihet shkurt; që kjo e fundit të ketë kohë të mjaftueshme për t'u afirmuar si Kancelare, me qëllim që në zgjedhjet e ardhshme parlamentare gjermane, aq më tepër të parakohshme, nëse do të ndodhë një gjë e tillë, CDU/CSU të fitojë dhe të vazhdojë qeverisjen e vendit pa Merkel.

Mirëpo, duke parë gjendjen konkrete të brendshme e të jashtme dhe ngjarjet të rëndësishme madhore, si zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe në tre lende ish-lindore këtë vjeshtë, me pasojë të paparashikueshme për të gjitha partitë politike gjermane, largimi qysh tani i Merkel është një rebus dhe ekuacion politik me disa të panjohura të mëdha; ndaj përpara se të hidhet një hap i tillë kërkohet një analizë tërësore e kostos dhe përfitimeve politike dhe mbi të gjitha një përgjigje optimale ndaj pyetjes madhore se " çdo të ndodhë më tej "

Sipas sondazheve serioze, në zgjedhjet e 23/26 majit për Parlamentin e ri Evropian, CDU/CSU mund të humbasë disa vende në Europarlamentin e ri. Gjithsesi, përmasat e kësaj humbjeje të mundshme mbeten për t'u parë. Për më tepër se kandidati kryesor si President i Komisionit Evropian nga qendra e djathtë evropiane është Manfred Weber i CSU bavareze, aleat dhe "motër" politike e Merkel.

Ndaj, për të kuptuar më mirë aktorët dhe faktorët, rëndësinë, pikëpyetjet, vështirësitë dhe logaritjet e nevojshme politike, le të shpjegojmë pasojat e mundshme të kësaj dileme të re merkeliane.



Fakti i parë dhe kryesor që përjashton dorëheqjen e saj të parakohshme është ndonëse me rënie brenda CDU-së, popullariteti i Merkel në Gjermani dhe jashtë saj është në kulmet e veta.

Pyetja tjetër e rëndësishme që kërkon përgjigje në një plan afatmesëm është se çdo të ndodhte me Zonjën AKK si Kancelare e re nëse CDU do të pësojë humbje të thellë në zgjedhjet evropiane dhe në vjeshtë në tri lëndet lindore? A nuk do të ishin këto shuplaka të forta politike dhe zgjedhore për Kancelaren e re pa përvojë qysh në fillim të mandatit të saj? Aq më tepër, kur sfidanti i saj kryesor, Friedrich Merz, pas humbjes tejte të ngushtë në garën për kreun e CDU-së dhjetorin e kaluar ka shumë të ngjarë të jetë dhe ai kandidati për Kancelar?

Veç kësaj, është politikisht dhe organizativisht logjike të mendohet se duke shkuar në zgjedhjet e lartpërmendura me duon AKK-Merkel, rezultati ka shumë më tepër të ngjarë të jetë më i mirë. Por, dhe nëse CDU do të pësonte një humbje, ca më tepër të rëndë, sërish faturën politike do ta paguajë Merkel, duke dhënë dorëheqjen e parakohshme nga posti i Kancelares. Pas kësaj, AKK mund të hynte e freskët në betejë me argumentin se nuk ka as një vit në detyrë dhe sfidanti i saj Friedrich Merz nuk do të "kishte gojë të fliste" sepse përgjegjësinë politike do e marrë në çdo rast Merkel.

Nga ana tjetër, largimi i menjëhershëm i Merkel është praktikisht i pamundur, sepse atletët e saj, social-demokratët e SPD-së nuk e pranojnë këtë ndryshim dhe ata mund të largohen nga koalicioni. Pas kësaj, vërtet mund të mos ketë zgjedhje të parakohshme, sepse CDU do të kërkojë qeveri të re me liberalët. Mirëpo këta të fundit, ashtu si dhe në fillim do të kenë kërkesat dhe pretendimet e tyre programatike; kësaj, krijimi i qeverisë së re do të kërkonte kohë, mund dhe shumë energji. Për më tepër tani kur janë ndezur fuqishëm motorët e fushatës së zgjedhjeve evropiane.

Ndërkohë, zgjedhjet e reja të parakohshme janë varianti më i keq dhe i papranueshëm për të gjitha forcat e moderuara politike dhe "dhuuratë" për partitë e ekstremist të majtë dhe të djathtë që mezi presin.

Një variabël tjetër i madh i panjohur është ecuria dhe rezultatet e pritshme të aleatës së Merkel, SPD-së në zgjedhjet evropiane. Sondazhet tregojnë se gjasat nuk janë të mira. Kësaj, po që se SPD pëson ndonjë katastrofë tjetër zgjedhore, atëherë ekziston rreziku që ajo të largohet nga koalicioni dhe të dalë në opozitë, me qëllim që të riorganizohet dhe ringrihet për zgjedhjet e ardhshme. Këtë ata e kanë paralajmëruar dhe më parë. Në fakt, qenia në koalicion me CDU e Merkel për të tretën herë radhazi ka ndikuar mjaft negativisht për SPD-në; ajo ka krijuar zhgënjime të shumta te elektorati i vet duke krijuar perceptimin e gjerë publik se ajo është vetëm për pushtet dhe si "patericë" e Merkel duke tradhtuar bazën e saj elektorale. Rënia e saj aktuale në nivelet

më të ulta historike prej 15 për qind është kampion e fuqishme alarmi për lidhshimin e SPD-së dhe kalimi në pozitë është e vetmja alternativë me kosto por që mund të premtojë diçka për të ardhmen e saj të afërt.

Largimi i SPD-së, siç u përmend më lart nuk çon detyrimisht në zgjedhje të parakohshme, por krijimi i një koalicioni të ri të mundshëm me të Gjellberit apo Liberalët do të kërkojë sërish menjëherë "kokën" e Merkel.

Për rrjedhojë, rasti më i "artë" për Merkel që të vijojë Kancelarinë deri në fund të mandatit të saj në vjeshtën 2021 është një rezultat i mundshëm bindës e sidomos fitore në të katër fushatë e lartpërmendura zgjedhore. Diçka tejet e vështirë, por gjithsesi jo e pamundur.

E megjithatë, si politikane kalibri, sipas disa ekspertëve dhe në rastin më të mirë, Merkel ka shumë të ngjarë të japë dorëheqjen disa muaj përpara vjeshtës 2021, me qëllim që t'i krijojë hapësirën dhe kohën e nevojshme për AKK-së si Kancelare e mundshme.

Deri tani u përmendën aspektet e brendshme, por largimi i parakohshëm i Merkel lidhet dhe me gjendjen ndërkombëtare. Aq më tepër që sfidat dhe rreziqet janë të panumërta dhe serioze në çdo cep të Evropës dhe të botës. Veç përplasjeve të mëdha gjeo-strategjike ndërmjet SHBA-vë, Rusisë, Kinës, fatit të Brexitit, përshkallëzimit të populizmit dhe ekstremizmit, edhe vetë BE-ja e NATO, ku Gjermania luan rol qendror përballat me shumë

rreziqe dhe kërcënime. Ndaj, zëvendësimi i parakohshëm i Merkel do të krijonte boshllëqe të mëdha në lidhshimin evropian të cilat nuk mund të mbushen brenda disa muajve apo dhe në një vit. Sepse bëhet fjalë për Merkel, grupin më të fuqishëm politikë në botë, dhe "violina e parë" evropiane për mbi 13 vite dhe 20 vite si lidere e CDU-së.

Largimi i Merkel është me pasojat të mëdha sidomos për Ballkanin Perëndimor dhe vendin tonë, të cilëve ajo u ka kushtuar një pjesë të madhe të aktivitetit të saj politik. Procesi i Berlinit, vizitat e saj në vendet e rajonit dhe në Shqipëri, nxitja e dialogut politik Serbi - Kosovë, "JO"-ja e saj shpëtimtare ndaj çdo ndryshimi/këmbimi kufiri ndërmjet tyre dhe mbështetja për çeljen e negociatave tona me BE-në, megjithë kundërshtimet e njohura dhe vetë brenda rradhëve të saj janë vetëm disa prej shembujve më domethënës e të freskët të mbështetjes së saj të fuqishme. Takimi që ajo me Presidentin Macron organizon më 29 Prill në Berlin me liderët e Ballkanit Perëndimor është në vazhden e trashëgimisë së saj politike për rajonin tonë.

Ja, për të gjitha këto shkaqe dhe arsye " të qëndrojnë apo të shkojnë " është shumë më tepër se një dileme merkeliane. Këtë e kanë kuptuar dhe ata që kërkojnë largimin qysh tani të Merkel, ndaj zërat e tyre janë zbehur ndjeshëm. Aq më tepër, kur sipas sondazhit më të fundit gjerman, mbi 59 për qind e të anketuarve mbështetin vazhdimin e Merkel si Kancelare deri në fund të mandatit në vitin 2021.

Ndaj, ashtu siç është shprehur ish-ministri gjerman Joschka Fischer ndoshta mund të kemi " një lamtumirë të zgjatur " të Merkel.

Së fundi, dhe më e rëndësishme, është e vërtetë që Merkel ka deklaruar se pas vitit 2012 nuk do të mbajë më asnjë funksion politik; megjithatë, po dëgjojmë dhe zëra politikë me peshë që pohojnë se interesat dhe shpëtimi i Evropës mund të kërkojnë dhe ta detyrojnë atë që pas zgjedhjeve të 26 Majit të japë dorëheqjen si Kancelare, këtë radhë pa pasojat e lartpërmendura, me qëllim që falë përvojës së saj unike, Merkel të vihet në krye të Komisionit Evropian në vjeshtën e këtij viti. Edhe pse kandidati kryesor është Manfred Weber, dihet se fjalën e fundit e ka Këshilli i BE-së. Por, për këtë duhen pritur rezultatet në zgjedhjet evropiane me rrjedhojat dhe pasojat e tyre.

Gjithsesi, cilido të jetë fati i saj i mëtejshëm politik, pësha, jehona dhe ndikimi i fenomenit Merkel, kësaj " veprë ideale të admirueshme arti " të politikës, siç është shprehur disa ditë më parë Jean Claude Juncker, do të vazhdojnë të jenë të pranishëm tonë ; si shkollë e re moderne e mendimit politik dhe pikë emblematike referimi në përballimin e sfidave të reja madhore.

Opinion *i* Ditës

Përrallat e 1 prillit dhe grabitja e 9 prillit

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... dhe me zë të lartë, pa u shqetësuar se e dëgjonin të gjithë aty rrotull, "Rama dhe Lleshaj e kanë organizuar grabitjen në Rinas. Po, ore po. Kjo bo mu, a s'e kupton? Janë 6 milionë e gjysmë euro, o vlla! Punë sekondash, kanë vjedh si nëpër filmat e Hollivudit. Fiks aq pare u duhen për fushatë në qershor, për zgjedhjet. Shtatë milionë euro na kushton fushata, ka thënë Saje qorri(i referohej ish-ministrit të brendshëm). Dhe ja ku dolën!". Unë me një shokun tim që ishim ulur aty ngjitur pamë njeri-tjetrin në sy, por nuk folëm. Grabitja e 9 prillit në Rinas në barkun e avionit tek ne ka ndezur përfytyrimet e qytetarëve të thjeshtë. Hamendësimet, të ushqyera bollshëm nga një propagandë e shfrenuar partiake, janë nga më të bollshmet. Zgjerimi i rrethit të të përfshirëve në grabitje në Elbasan dhe Fushë-Krujë nuk i ka zbehur aspak teoritë konspirative të qytetarëve. Madje ka edhe gazetarë që duken të bindur se shteti ka dorë në të(?). Edhe pse çfarëdolloj segmenti shtetëror që mund të përfshihej (Ministria e Brendshme, policia, SHISH, SHIK e me radhë), të vetmin interes në vjedhje do ta kishte patur të mos ishte grabitja kaq spektakolare. Pra, të punësuarit në shtet të vidhin butë-butë, komodë, pa shkëmbim zjarri me policinë. Kushdo që nga shteti do të donte të planifikonte një vjedhje të tillë, do ta kishte bërë jo në stilin hollivudian. Pse kush punon në shtet, e di mirë që nuk kapet kur vjedh pa zhurmë. Zhurma, spektakli me grabitje, është armiku numër një i vjedhësit nga brenda shtetit. Dhe sigurisht që ata në segmentet e shtetit që mund të ishin përfshirë, i kishin të gjitha mundësitë ta bënin grabitjen pa zhurmë. Kush punon në shtet, di si ta bëjë këtë gjë. Prandaj është armata e të korruptuarve tanë në zyrat e Shtetit. Megjithatë, armata mediatike bal-tëdhëse, e gatshme për veprim solli skenarë të prodhuara nga mendje të sëmura dhe halucinante (që fantazinë e tejskajshme e marrin për realitet). Dhe kështu u politizua deri në rrenjë të flokëve edhe grabitja e shekullit. Dora e shtetit në një grabitje keqbërësish të rëndomtë, edhe pse mirë të organizuar, ngjan më shumë me përrallat e 1 prillit. Mirëpo, armata e "shpif, shpif se diçka ngelet" i hodhi katapultat e radhës. Dhe me politizimin e ngjarjes, rritet demoi që i bëhet sistemit tonë bankar. Ngrihet një imazh i rremë sikur bankat janë vegla dhe masha të politikës së sotme (sidomos të qeverisjes). Sikur shteti mund fare lehtë të vërë



dorë mbi depozitat e qytetarëve që administrohen nga bankat tregtare në vend, sa herë ai është i aftë të lidhet me bandat kriminale. Kjo fantazi e sëmure dëmton sigurinë e sistemit tonë bankar dhe politika, për interesat e saj dritëshkurtra, po tregohet fare e përpërgjegjshme. Guvernatori i bankës sonë qendrore, Bankës së

Shqipërisë bëri mirë që sqaroi se sigurua e vlerave monetare i takon sistemit për sa kohë këto vlera qëndrojnë brenda tij, pra tek bankat tregtare. Kur vlerat monetare, paratë lëvizin, siguria është përgjegjësi e institucionit që garanton lëvizjen e tyre. Prej këtej, është mirë të kuptohet që grabitja në bark të avionit nuk ka të bëjë me

sa i sigurte apo i pasigurtë, sa i mbrojtur apo i pambrojtur është sistemi ynë bankar. Ai, sikurse e theksoi edhe vetë Guvernatori i BSH-së është i sigurtë, pse i mirëkapitalizuar (shprehje për të thënë se bankat janë plot me para. Dhe vërtetë ashtu janë, pse mbajnë 7.9 miliardë euro depozita të qytetarëve tanë). Kuptohet që kur vjedhjet dhe grabitjet e parave të bankave shtohen në numër dhe raste, sistemi bankar preket edhe ai. Për momentin, grabitja e shekullit ka dëmtuar imazhin tonë si vend i sigurtë për investime dhe për këtë, duhet të shqetësohemi e të punojmë që të gjithë, si institucione dhe opinion publik dhe media, që të japim kumtet e një vendi të sigurtë, sikurse realisht jemi. Grabitjet e stilit hollivudian, të amplifikuara nga politika, vetëm sa na dëmtojnë në interesin tonë kryesor, në rritjen e pranisë së investimeve të huaja tek ne. Për këtë duhet të punojmë, dhe jo për të ushqyer fantazitë e sëmura, qoftë edhe të politikaneve tanë. Sa për qytetarët, ata është e natyrshme të kenë skenarë hipotetikë, duke u ushqyer e sëmure e partive tona të përpërgjegjshme politike.

Janë 6 milionë e gjysmë euro, o vlla! Punë sekondash, kanë vjedh si nëpër filmat e Hollivudit. Fiks aq pare u duhen për fushatë në qershor, për zgjedhjet. Shtatë milionë euro na kushton fushata, ka thënë Saje qorri(i referohej ish-ministrit të brendshëm). Dhe ja ku dolën!". Unë me një shokun tim që ishim ulur aty ngjitur pamë njeri-tjetrin në sy, por nuk folëm. Grabitja e 9 prillit në Rinas në barkun e avionit tek ne ka ndezur përfytyrimet e qytetarëve të thjeshtë. Hamendësimet, të ushqyera bollshëm nga një propagandë e shfrenuar partiake, janë nga më të bollshmet.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet të tremben nga pengesat e përkohshme. Pranoni atë çfarë do të ndodhë gjatë ditës dhe konsiderojeni si mësim. Nëse dëshironi dhe nëse përpiqeni fort, mund t'i zgjidhni telashet.

DEMI

Mund të përmbushni shumë detyra gjatë kësaj të premte. Fati do t'ju ndihmojë në çdo iniciativë. Mund të hasni probleme vetëm në marrëdhëniet personale. Mos u mbështetni plotësisht te miqtë, pasi disa prej tyre mund të veprojnë tërësisht ndryshe nga ç'mund ta kishit menduar.

BINJAKET

Binjakët nuk do të kuptohen plotësisht me të afërmit. Ndoshta ata nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë idetë tuaja aventureske dhe nuk do t'i mbështesin planet për ndryshim. Vepromi ashtu siç mendoni se është më mirë dhe mos rezikoni me paratë.

GAFORJA

Gaforret do të mund të harrojnë disa prej problemeve të tyre. Ka gjasa që sot të keni shumë fat. Sa u përket ndjenjave, shoqërisë apo martesës, nuk rekomandohet që t'i besoni intuitës. Nëse dëshironi të ndryshoni diçka, mendohuni mirë.

LUANI

Luanët mund ta kalojnë këtë të premte me sukses, por vetën në disa kushte të caktuara. Së pari, mos besoni te lajkat e bukura nga të huajt. Së dyti, mos u tregoni mendjemdherj ndaj atyre që nuk kanë arritur rezultate mbresëlënëse në dashuri apo karrierë.

VIRGJERESHA

Mund të përballeni me vështirësi sot, sidomos në rastet kur kërkohen njohuri të veçanta. Rekomandohet që sot të përqendroheni tek mënyrat sesi të rritni profesionalisht. Mos u nxitoni në marrëdhëniet personale. Nëse gjatë një bisede përfshihen thashetheme, përdorni diplomacinë.

PESHORJA

Disa Peshore do të nisnin një kapitull të ri në jetën e tyre. Mund të provoni eksperimentet në dashuri, të shihni për një profesion të ri ose të ndërmerrni një hap të rëndësishëm në fushën e financave. Nuk është dita e duhur për negociata të rëndësishme.

AKREPI

Mund të ndiheni të tensionuar nga disa pyetje. Është e rëndësishme t'i kushtoni më shumë kohë vetes suaj. Mos u mbingarkoni në punë dhe në shtëpi. Rekomandohet që në një moment të caktuar të shkëputeni dhe të relaksoheni si fizikisht, ashtu edhe psikologjikisht.

SHIGJETARI

Shmangni skemat e quditshme, aventureske apo pasurimin e paligjshëm. Një risk i tillë nuk është i mirëpritur në çështjet profesionale. Merrni për bazë të gjitha udhëzimet e drejtuesve tuaj në punë. Eksperimentet e vogla janë të mirëpritura në dashuri.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do të surprizohen nga disa ndryshime të këndshme në jetën e tyre të përditshme. Ekziston mundësia se një çështje komplekse, që ka lidhje me një deficit financiar të zgjidhet. Do të keni fat në çështjet personale.

UJORI

Sot do të përfshihen nga disa ide apo projekte të pazakonta. Kjo mund t'ju sjellë rritje të ardhurave, ose do të fitoni respekt në shoqëri për t'u bërë të famshëm. Ujorët duhet të tregohen me mjaft takt këtë të premte, kur të komunikojnë me partnerin/partneren.

PESHQIT

Peshqit do të përballen me disa surpriza të këndshme sot. Ekziston mundësia që një mik i juaj i vjetër të rikthehet, ose mund të pajtohemi me ish-partnerin. Në mbërmjeje do t'ndiheni të lodhur emocionalisht. Shmangni bisedat e panevojshme.

Nga talent i Juventusit, në lojtar normal te Dinamo e Bukureshtit, mesfushori rihap plagët

Historia e Elvis Kabashit është një nga refuzuar Shqipërinë për një kombëtare tjetër dhe për asnjë moment nuk kanë arritur të shohin sukses. Sulmuesi, i cili dikur ishte pjesë e Juventusit në Itali, refuzonte Shqipërinë duke qenë se dëshira e tij ishte të luante për Italinë dhe këtë e bënte nëpërmjet një letre zyrtare të dërguar në FSHF. Kabashi është përndryshe dhe për të treguar që realisht ka dëshirë të luajë për Shqipërinë, ka nisur të gënjejë hapur me pretekstin se atë letër e ka dërguar menaxheri i tij në FSHF, ndërkohë që në të vërtetë ka qenë babai i tij, ai i cili ka bërë me dije diçka të tillë. Në një prononcim për "Digisport.ro", Kabashi është shprehur se punon fort që një ditë të arrijë të Shqipëria, pasi dëshira e tij është që të luajë për kuqezinjët. "Me Alijin kuptohemi shumë mirë dhe kemi një marrëdhënie shoqërore dhe jashtë fushë. Është mirë të jesh në një ekip me një shqiptar tjetër. Shpresoj, sepse ka pasur disa keqkuptime sa i përket grumbullimit tim me Kombëtaren. Është folur për një letër që unë kam shkruar, por nuk është e vërtetë, sepse letrën e pati shkruar ish-menaxheri im, me të cilin kam disa gjyqe të hapura. Ajo letër më pozicionoi kundër Kombëtares, sepse nëse unë nuk do të doja të luaja me Shqipërinë, nuk do të luaja as me 19-vjeçarët

Tradhtari' Kabashi: Jam shqiptar, krenari të luaj për ngjyrat kuqezi

6 vite më parë refuzoi të grumbullohej me ekipin U-19



në eliminatoret e Europianit. Prindërit e mi janë shqiptarë, unë kam lindur në Itali, por gjaku im është ai i një shqiptari, ndaj nuk ka arsye pse ta refuzoj Kombëtaren e Shqipërisë. Gjithë këtë rrëmujë e ka shkaktuar ish-menaxheri, i cili nuk donte që të luaja me Kombëtaren, por të përqen-

drohesha vetëm te Juventusit. Njerëzit kanë të drejtë të më gjykojnë, pasi nuk e dinin të vërtetën, ndërsa unë nuk kam folur më parë për këtë letër, sepse nuk kam shkruar asgjë dhe në ndërgjegjen time jam i qetë. Ndoshta duhet të isha kundërpërgjigjur, por mu duk sikur do t'i hidhja ben-

zinë zjarrit. Tani është në dorën time të tregoj se sa e rëndësishme është Kombëtarja për mua. Shpresoj të grumbullohem, pasi është një krenari të mbrosh ngjyrat e vendit tënd. Do të përpigë të stërvitem e të punoj sa më shumë për t'u rikthyer në Kombëtare", tha Kabashi.

Formacioni i vitit

Siti dhe Liverpool me 10 lojtarë, Pogba "outsider"-i i vetëm

Manchester Siti dhe Liverpooli dominojnë ekipin e vitit në Premierligë, por në 11 lojtarët e përzgjedhur nuk ka vend për Eden Hazard e as për Momo Salah, që sezonin e shkruar u shpall lojtari i vitit në ishull. Formacioni ideal i publikuar nga Shoqata e Futbollistëve Profesionalistë sheh pjesën dërrmuese të tij të dominuar nga Siti dhe Liverpooli, që po udhëheqin kampionatin. "Qytetarët" e Guardiola's kanë plot 6 lojtarë në këtë formacion, portierin Eder-son, Laporten, Bernardo Silvën, Fernandinjon, Sterling dhe Agueron. Ndërsa "Red"-sat kanë katër lojtarë, Arnold Van Dijk, Robertson dhe Mane. I vetmi "outsider" në këtë formacion është Pol Pogba i Manchester Junajtidit, që plotëson kështu formacionin ideal.



GATI PROJEKTI

Roma ka gati rikthimin në Serinë A të Antonio Kontes

Sezoni në kampionatin Italian është në momentin vendimtar për të vendosur se cila nga skuadrat do të marrë pjesën në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Në lojë janë disa ekipe, mes tyre edhe Roma. Viti i verdhekuqve nuk ka qenë në nivelet e pritura në fillim sezonit, çka solli më pas shkarkimin e trajnerit Eusebio Di Francesko. Postin e tij e zuri një njohje e vjetër si Klaudio Ranieri. Megjithatë, tekniku duket se nuk do të jetë pjesë e skuadrës për sezonin e ardhshëm, edhe nëse ekipi ia del të kualifikohet në Champions League. Në këtë formë drejtuesit romanë janë vënë në kërkim të trajnerit të ri, ndërsa informacione e fundit në Itali flasin për kontakte që zgjasin prej 4 muajsh të klubit kryeqytetas me Antonio Konten. Ish-trajneri i Italisë dhe Juventusit duket



se është i gatshëm të nisë sërish punë në Serinë A. 49-vjeçari duket se është i gatshëm të marrë përsipër drejtimin e ekipit, por kërkon një program ambicioz. Për Konten ka gjith-

ashtu interesim edhe nga klube të tjera, teksa Interi mbetet i vëmendshëm ndaj situatës. Por, duket se është Roma që udhëheq garën, pasi kontaktet kanë nisur prej kohësh.



Maldini e Leonardo shkojnë në Milanelo

Dridhet stoli i Gatuzos, drejtuesit shkundin ekipin

Stoli i Gatuzos mbetet i rrezikuar. Eliminimi nga Kupa e Italisë, por mbi të gjitha loja aspak e mirë që skuadra ka zhvilluar ndeshjet e fundit ka lëkundur pozitaz e trajnerit italian. Sipas asaj që raporton "Tuttosport", sfida e radhës me Torinon mund të jetë vendimtare për Rinon. Pronari i Milanit, Fondi Eliot, është i pakënaqur me ecurinë dhe mosarritja e zonës Champions do të ndryshonte shumë gjëra te kuqezinjët, pavarësisht se Gatuzo ka ende dy vite kontratë me Milanin. Por, pavarësisht presionit të lartë të orëve të fundit, Leonardo dhe Maldini kanë qenë prezente para-ditën e djeshme në Milanelo për një ballafaqim me skuadrën. Qëllimi i vizitës së tyre ka lidhje të drejtpërdrejte me përballjen kundër Torinos, teksa dyshja e drejtuesve ka kërkuar të shkundë futbollistët përpara sfidës që vlen sezonin për kuqezinjët.

Pronari i Milanit, Fondi Eliot, është i pakënaqur me ecurinë dhe mosarritja e zonës Champions do të ndryshonte shumë gjëra te kuqezinjët.


BEJL DHE RAMOS



Zbulohet rroga faraonike që Hazard do të marrë në Madrid

Eden Hazard sipas të gjitha gjasave do të jetë një lojtar i Realit sezonin që vjen dhe tashmë mbeten vetëm disa detaje që të arrihet akordi përfundimtar. Sipas asaj që transmeton "The Sun", Hazard në vit do të arketojë 24 milionë euro neto. Nga ana tjetër, Çelsi do të fusë në arkat e veta plot 116 milionë euro. Shifra faraonike këto për belgun, i cili është kërkuar me ngulm nga Realit për disa sezona. Në javë 28-vjeçari do të përfitojë 400 mijë sterline. Këtë rrogë Realit ia ka mundësuar më përpara vetëm Ronaldos. As Bejl dhe as Ramos nuk marrin një rrogë të tillë. Uellsiani përfiton 15 milionë euro në sezon, ndërsa spanjollli 10.2.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Riza aktor.
- Një fjalë si hiç.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premton të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Qe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrintare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka bërë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.

- Rastisin në krye.
- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indie).
- Triplet e Tiëndafie me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

VERTIKAL

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstreme në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë llogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Ruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprinë hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rrallë.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsriste.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinari i planetit të kuq.

VERTIKAL


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë gift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinas.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëlljo për latinë.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rrallë është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4 | | 5 | 8 | | 7 | 3 |
| 2 | | 7 | | | | | | 8 |
| | | 6 | 2 | | 7 | 5 | | |
| 4 | 1 | | | 8 | 3 | | | |
| | 3 | | 1 | | 6 | | 5 | |
| | | | 7 | 9 | | | 2 | 1 |
| | | | 5 | 3 | | 1 | 4 | |
| 6 | | | | | | 9 | | 2 |
| 8 | 7 | | 9 | 4 | | | 1 | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 5 | 3 | 1 | 9 | 4 | 7 | 2 | 6 |
| 1 | 4 | 6 | 2 | 3 | 7 | 8 | 5 | 9 |
| 2 | 7 | 9 | 8 | 5 | 6 | 3 | 1 | 4 |
| 4 | 2 | 1 | 6 | 7 | 3 | 9 | 8 | 5 |
| 3 | 6 | 5 | 9 | 8 | 1 | 4 | 7 | 2 |
| 7 | 9 | 8 | 4 | 2 | 5 | 6 | 3 | 1 |
| 9 | 1 | 7 | 3 | 4 | 2 | 5 | 6 | 8 |
| 6 | 3 | 4 | 5 | 1 | 8 | 2 | 9 | 7 |
| 5 | 8 | 2 | 7 | 6 | 9 | 1 | 4 | 3 |

Argëtim filozofik

- Të qeshësh me gabimet e tua, të zgjat jetën. Për të qeshësh me gabimet e të tjerëve, mund të ta zvogëllojë.

- Një fëmijë hyn në shtëpinë tuaj dhe bën aq zhurmë për njëzet vjet, e cila është e vështirë të durohet. Pastaj, largohet duke e lënë shtëpinë aq të heshtur sa që mendoni se do të çmendeni.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 6 | 1 | 9 | 13 | 15 | 11 | 7 | 2 | 1 | 11 | 2 | 7 |
| 4 | 9 | 12 | 4 | 11 | 2 | 2 | 14 | 13 | 15 | 8 | 2 |
| 1 | 12 | 4 | 2 | 12 | 4 | 11 | 6 | 1 | 8 | | |
| 4 | 11 | 2 | | 5 | 10 | 3 | 1 | 15 | | 12 | 2 |
| 7 | 4 | 12 | | 5 | 10 | 3 | 4 | 6 | 1 | 7 | 2 |
| 3 | | | | 5 | 10 | 3 | 1 | 14 | 4 | 6 | 1 |
| 4 | 12 | 2 | | 5 | 1 | 7 | 2 | 12 | | 11 | 4 |
| 7 | 10 | 6 | 10 | 14 | 4 | 5 | | 12 | 10 | 7 | 4 |
| 12 | 11 | 1 | 9 | 4 | | 12 | 6 | | 8 | 15 | 8 |
| 1 | 12 | | 12 | 15 | 12 | 15 | | 1 | 12 | 1 | 14 |
| 7 | 2 | 14 | 4 | 12 | | 7 | 10 | 15 | 15 | 3 | 4 |
| 4 | 12 | 1 | 7 | 9 | 4 | 7 | 9 | 4 | 11 | 4 | 12 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | I | K | E | | K | M | S | | E | | |
| E | K | A | | R | O | M | A | K | E | T | |
| K | M | I | L | I | T | A | N | T | E | T | |
| M | A | T | E | M | A | T | I | K | A | | |
| P | A | S | A | N | I | K | T | | S | | |
| E | K | U | | A | N | E | T | A | R | E | T |
| R | E | T | R | E | | I | R | A | N | I | |
| I | T | R | E | B | L | A | K | E | L | | |
| M | I | A | | R | E | D | | E | K | I | |
| E | | | M | E | T | A | L | E | I | S | |
| T | E | K | E | | M | K | U | M | T | | |
| M | O | R | A | V | I | A | | M | A | E | |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | K | A | A | S | T | R | O | K | M | A |
| D | I | A | N | A | H | A | N | T | I | K | |
| A | T | L | A | N | T | I | K | E | O | L | S |
| P | E | I | T | A | R | I | F | A | T | L | E |
| T | T | P | O | L | I | T | I | K | A | N | E |
| | | | K | E | N | E | T | A | O | R | A |
| P | A | U | L | I | N | R | R | I | | | |
| A | K | E | O | T | A | A | D | D | I | M | |
| R | U | M | U | N | E | K | I | E | R | A | |
| E | I | J | I | T | E | R | I | A | M | A | N |
| T | E | I | T | G | O | R | D | I | A | N | E |
| I | N | T | A | R | O | M | A | T | I | T | |
| P | A | B | M | E | L | E | R | C | O | | |
| R | K | U | P | A | E | M | I | R | A | T | E |
| O | H | A | R | A | D | A | R | O | M | A | T |
| C | I | K | L | I | S | T | E | T | | | |
| S | T | A | D | I | U | M | E | T | A | P | E |
| D | I | K | A | S | I | E | R | E | R | U | E |
| K | E | N | T | I | N | G | O | P | J | E | V |
| K | A | T | L | A | S | I | E | S | E | | |
| A | R | K | N | I | O | L | L | A | R | | |
| M | A | S | S | I | M | O | Z | A | N | O | R |
| A | M | A | N | A | N | A | N | | | | |
| T | T | E | R | E | N | I | E | I | N | E | |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Dështimi i përgatitjes është përgatitja e dëshmitit.
- Shkoni aq larg sa mund të shihni. Kur të arrini atje, do të jeni në gjendje për të parë akoma më larg.
- * Dashuria është çështje fizike, martesja është çështje kimie.

